



**P R O G R A M I**  
**PUNËS SË QEVERISË**  
**2017 - 2020**

Në bazë të rezultateve të fituara nga zgjedhjet e parakohshme parlamentare, të mbajtura më 11 dhjetor të vitit 2016, partitë politike që fituan shumicën e vendeve të deputetëve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, sollën vendim për krijimin e shumicës parlamentare me qëllim të formimit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë.

Partitë politike japin përkrahje të plotë për formimin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë me mandate për të realizuar përcaktimet politike të këtij:

## **PROGRAMI I PUNËS SË QEVERISË 2017-2020**

Shumica parlamentare, e përkushtuar fuqishëm në forcimin e unitetit, sovranitetit dhe stabilitetit të Republikës së Maqedonisë, e deklaroi vullnetin e vet politik për formimin e një qeverie reformuese, e cila do të fokusohet në prioritetet e përbashkëta strategjike të Republikës së Maqedonisë, anëtarësimit në NATO dhe Bashkimin Evropian si dhe të sigurojë tejkalim të shpejtë dhe të qëndrueshëm të krizës politike duke siguruar një ndarje reale të pushtetit, funksionimit të shtetit juridik dhe ndërtimit të institucioneve të fuqishme dhe profesionale.

Partitë politike japin përkrahje të plotë për formimin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë e cila në tërësi, duke respektuar Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë dhe obligimet e saja ndërkombëtare, do të punojë për bashkimin e të gjitha fuqive politike pas platformës për një Republikë të Maqedonisë evropiane dhe euroatlantike. Prioritetet politike të Qeverisë do të bazohen mbi rekomandimet e “Raportit të Pribes”, si dhe prioritetëve urgjente të definuar nga Bashkimi Evropian.

Shumica parlamentare do të jetë e përkushtuar për ndërtimin e marrëdhënieve të mira ndëretnike, në bazë të parimeve të respektit të ndërsjellë dhe tolerancës dhe zbatimit të Marrëveshjes Kornizë të Ohrit.

Agjenda e këtillë reformuese do të mundësojë që qëllimet e përbashkëta që i ndajnë qytetarët e Republikës së Maqedonisë, për një jetë më të mirë për të gjithë qytetarët, zhvillimin e ekonomisë, kthimin e demokracisë, sundimin e së drejtës dhe drejtësisë, barazisë së qytetarëve, institucionet efikase, arsimin dhe shëndetësinë cilësore si dhe përmirësimin e reputacionit dhe pozitës ndërkombëtare të Republikës së Maqedonisë.

## **Rritja ekonomike, më tepër vende të punës, standard më i lartë**

Fokusi kryesor i Programit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për periudhën kohore 2017-2020, do të jetë zhvillimi i ekonomisë dhe rritja e standardit jetësor të qytetarëve.

Qeveria ka një përcaktim të fortë për përkrahjen e ndërmarrjeve vendase, para se gjithash ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, që investojnë dhe hapin vende të punës. Klima afariste do të çlirohet nga presionet dhe reprezaljet politike, ndërsa do të punohet edhe për lidhjen e ndërmarrjeve vendase me zonat teknologjike - industriale jashtë vendit. Vëmendje të veçantë Qeveria do t'i kushtojë rritjes së punësimeve në ekonomi. Me masat aktive për punësim, në sektorin privat planifikohet në nivel vjetor të punësohen nga 16 mijë persona.

Përcaktim i Qeverisë është edhe të insistojë në ngritjen e nivelit të pagave në ekonomi. Në fund të mandatit paga minimale në ekonomi duhet që t'i mbulojë shpenzimet e domosdoshme jetësore. Rritja e pagave duhet të bëjë presion për rritjen e produktivitetit ekonomik. Paralelisht me këtë proces do të sigurohet edhe mbrojtja e vendeve të punës.

Zhvillimi i ekonomisë nuk mund të sigurojë ngritjen e standardit jetësor të qytetarëve, nëse frytet e sajë ndahen padrejtësisht. Qeveria ka për qëllim që gradualisht të vendos drejtësi në të dy mekanizmat kyç për redistribucion në ekonomi - sistemit tatimor dhe atij social. Ndryshimet në transferimet sociale dhe tatimore do të inkorporohen së bashku me përmirësimin e efikasitetit të institucioneve.

Hapi i parë në përmirësimin e efikasitetit të institucioneve është sigurimi i transparencës së plotë financiare. Kjo paraqet prioritetin kryesor të punës së Qeverisë, në vitin e parë të mandatit. Transparencë plotësuese fiskale do të mundësoj që opinioni i gjerë të ketë edhe pasqyrë të qartë për situatën reale të financave publike.

## **Sistem i drejtë tatimor**

Qëllimi i qeverisë në periudhën e ardhshme katërvjeçare është më shumë sigurim të së drejtës në sistemin tatimor, me qëllim që të bëhet korigjimi i shpërndarjes jo të drejtë të të hyrave dhe pasurisë shoqërore. Ndryshimet në sistemin tatimor do të inkorporohen paralelisht me sigurimin e transparencës në shpenzimin e parave të qytetarëve përmes buxhetit shtetëror, ndërsa do të ndërmerren edhe këto masa më të rëndësishme:

- Futja e një tatimi më të drejtë personal të të hyrave me dy shkallë (10% dhe 18%) që do të përmbajë edhe kthim të tatimit personal të të hyrave për qytetarët të cilët kanë të hyra shumë të ulëta personale në nivel mujor. Për shumicën e qytetarëve do të mbetet shkalla prej 10% kurse shkalla plotësuese prej 18% do të futet vetëm për të hyrat shtesë për personat me të hyra më të larta.
- Shfuqizimin e kufirit më të lartë maksimal për kthimin e kontributeve të pagave.
- Futja e mundësisë që shkalla tatimore e tatimit të pronës për pronë të patundshme rezidente dhe jorezidente me vlerë tregtuese më të lartë se 400.000 euro, të rritet për 0,1 % pikë të përqindjes. Do të futet edhe tatimi më i drejtë gjatë posedimit të më tepër pronave.
- Rritja e shkallës së akcizës për automjetet e udhëtimit me vlerë me të lartë se 40 mijë euro.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë do të inkorporojë një sistem të ri “Më shumë para te qytetarët” me të cilin qytetarëve do t’iu kthehet 15% të TVSh-së së paguar, me përjashtim të tatimit të realizuar gjatë blerjes së prodhimeve luksoze. Sistemi do të përmbajë kufizime të cilat do të pengojnë keqpërdorime dhe shtresime më të mëdha.

### **Vende të reja të punës dhe paga më të larta**

Qëllimet themelore të Qeverisë në sferën e punës, në periudhën e mandatit janë punësimi në sektorin privat të 64.000 personave me ndihmën e masave aktive, ngritjes së pagës minimale në 16.000 denarë (deri në fund të mandatit) si dhe sigurimit të mbrojtjes më të madhe të të drejtave të punëtorëve. Një pjesë e masave do të stimulojnë pagesën e pagave më të mëdha me qëllim që paga mesatare neto në Republikën e Maqedonisë të rritet deri në 30.000 denarë. Do të merren këto masa dhe aktivitete më të rëndësishme:

- Rritja e pagës minimale në 12.000 denarë gjatë vitit të parë të mandatit dhe ajo do të vlejë për tre seksionet me paga më të ulëta. Do të futet përkrahje financiare buxhetore për seksionet me paga më të ulëta, me qëllim të përshtatjes së tyre graduale ndaj këtij obligimi.
- Alokimin e 22 milion eurove për masa aktive për punësim. Do të insistohet që shumata të rritet çdo vit, me qëllim që në fund të mandatit të rritet në 33 milion euro.
- Stimulimi i hapjes së vendeve të punës më mirë të paguara. Do të vendoset një përkrahje e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme gjatë punësimit të personave të papunë, e cila do të ketë për qëllim hapjen e vendeve të reja të punës, injektimit të likuiditetit të ndërmarrjeve si dhe mbushjes së fondit për SPIM. Përkrahja do të realizohet për tri kategori të ndryshme të personave të papunë si dhe do të nënkuptojë përkrahje financiare prej 72.000 deri në 162.000 denarë, të cilat ndërmarrja do t’i marrë në fillim të periudhës, me kusht që personit t’i paguajë 12 muaj bruto pagë që është më e lartë se paga mesatare e vitit të kaluar.
- Futjes së projektit “Garanci për të rinjtë”, i cili do të sigurojë që në një periudhë prej katër muajve pas mbarimit të shkollimit ose mbetjes pa punë, çdo i ri të fitojë një ofertë punësimi, mundësi për vazhdimin e shkollimit, të kyçet në praktikë ose trajnim për përgatitje për punësim.
- Miratimi i një Ligji të ri për marrëdhënie pune, i përkushtuar për sigurimin e mbrojtjes së vërtetë të punëtorëve. Me të do të krijohet edhe regjistër për orë pune jashtë orari në DAP, marrëveshjet kolektive do të bëhen të obligueshme për të gjitha subjektet juridike me mbi 20 të punësuar, kurse sindikatat do të mund të regjistrohen vetëm në Regjistrin Qendror.
- Miratimi i një Ligji për sipërmarrësi sociale përmes të cilit do të lehtësohet qasja deri te tregu i punës për kategoritë e rrezikuara sociale të qytetarëve. Ndërmarrjet sociale do të ofrojnë mundësi që kategoritë e rrezikuara të menaxhojnë me ndërmarrjen, të sjellin vendime për menaxhim me të hyrat e realizuara si dhe investimin e tyre për qëllime sociale.
- Përmes ndryshimeve ligjore do të kufizohet kohëzgjatja e Kontratave të punës në kohë të caktuara dhe ato do të lidhjen me vendin e punës, e jo me realizuesin. Nëse bëhet fjalë për vend të ri të punës, Kontrata e punësimit në kohë të

- caktuar pas 6 muajve patjetër do të duhet të transformohet në punësim në afat të pacaktuar.
- Përmes ndryshimeve ligjore do të sigurohet që marrëdhënia e punës që pa ndërprerje zgjatë më tepër se 9 muaj (punëtorë sezonal) dhe që do të vazhdojë në vitin e ardhshëm kalendarik, të transformohet në marrëdhënie të punës në afat të pacaktuar.
  - Vlera dhe sasia e kompensimit për punëtorin në rast të shpalljes për tepricë teknologjike të rritet për 20%.
  - Përcaktimin e ndalesës për punësim të ri në periudhë prej 2-3 viteve, në rast të shpalljes së tepricës teknologjike, për të njëjtin vend të punës. Nëse punëdhënësi ka nevojë për punësimin e një personi për të njëjtin vend ose të ngjashëm të punës, atëherë patjetër duhet që ta kontaktojë personi që e ka shkarkuar në bazë të tepricës teknologjike.
  - Miratimi i një zgjidhjeje ligjore me të cilën do të mbrohen të punësuarit në rast të gjendjes në humbje të punëdhënësit të tyre.
  - Përfshirja e perspektivës gjinore gjatë marrëveshjeve kolektive në të gjitha nivelet, me qëllim të avancimit plotësues dhe mbrojtjes së punëtoreve.
  - Garantimi i kthimit në të njëjtin vend të punës pas pushimit të lindjes, si dhe ruajtja e të njëjtit vend gjatë vitit të ardhshëm.
  - Avancimi i legjisllacionit të punës me mbrojtje shtesë të grave shtatzëna punëtore.
  - Mundësimi i shfrytëzimit të përbashkët të pushimit prindëror të të dy prindërve për 1-3 muajt e parë (pas mbarimit të 3 muajve, nëna ose babai vazhdon deri në fund të pushimit të lindjes). Në rast të lindjes së binjakëve /trinjakëve pushimi prindëror (i përbashkët) zgjatë 3-6 muaj (pas mbarimit të 3 muajve nëna ose babai vazhdon deri në fund të pushimit të lindjes). Për fëmijën e dytë/tretë të lindur (jo në të njëjtën kohë) pushimi prindëror (i përbashkët) zgjatë 3-6 muaj (pas mbarimit të 3-6 muajve nëna ose babai vazhdon deri në fund të pushimit të lindjes).

## **Përkrahja e ndërmarrjeve vendase**

Prioritet i Qeverisë në ekonomi do të jetë zhvillimi i ndërmarrjeve vendase, para se gjithash ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Do të krijohet një klimë e shëndoshë dhe e parashikueshme afariste, pa presione dhe reprezalje politike. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet lidhjes së ndërmarrjeve vendase me zonat teknologjike-industriale jashtë vendit. Qëllimi ynë është realizimi i shkallës mesatare të rritjes së ekonomisë më lartë se 5% gjatë periudhës së mandatit.

Për këtë qëllim, Qeveria do të rris përkrahjen shtetërore për nxitjen e ndërmarrjeve vendase me 20 milion euro gjatë vitit të parë, kurse do të insistojë që ajo të arrij deri në 50 milion euro deri në vitin e fundit të mandatit. Këto mjete do të plotësohen edhe me linja të jashtme kredituese.

Ndërmarrjet vendase po ballafaqohen me problemin e obligimeve të papaguara nga ana e shtetit në bazë të faturave dhe kthimit të TVSh-së. Vlerësimet e odave ekonomike rreth shumës së këtij borxhi janë shqetësuese dhe dëshmojnë për një problem serioz të ekonomisë vendase. Për këtë qëllim, Qeveria në 100 ditët e para të mandatit do të shpallë shumën e përgjithshme të të gjitha obligimeve të akumuluar dhe të papaguara të shtetit. Menjëherë do të përpilohet plani për pagesën e tyre me afate të qarta, kurse Qeveria do të udhëheq një politikë të pagesës në kohë të obligimeve të papaguara. Nuk mund të kërkojmë disiplinë fiskale nga ndërmarrjet dhe qytetarët, ndërsa shteti të mos e respektojë të njëjtën.

Krijimin e klimës së favorshme afariste Qeveria do ta ndihmojë edhe me politika të bashkëpunimit me sektorin e biznesit, mosdiskriminimit, efikasitetit të rritur dhe transparencës së institucioneve si dhe respektimit të plotë të shtetit juridik. Kjo ndër të tjerash nënkupton:

- Krijimin e kanaleve të përhershme të komunikimit ndërmjet komunitetit të dhe Qeverisë. Qeveria dhe komuniteti i biznesit do të kenë komunikim të rregullt për konsultime para ndryshimeve ose miratimeve të rregulloreve të reja. Dialogu sistematik dhe i hapur me komunitetin e nënkupton edhe zbatim të plotë të Regjistrimit Nacional Elektronik të Rregulloreve (RNER). Në këtë drejtim, do të rritet edhe numri minimal i ditëve për konsultime prej në 20 deri në 30 ditë.
- Procedurat e shkurtuara kuvendare për miratimin e ligjeve që krijojnë pasiguri juridike dhe balast rregullator të ndërmarrjeve, do të jenë përjashtim dhe për to do të parashihen kufizime të veçanta. Gjatë ndryshimeve të ligjeve do të parashihen edhe periudha për përshtatjen e ndërmarrjeve, sidomos për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Kuvendi do të përpilojë tekste të spastruara ligjore sipas sugjerimeve të OJQ-ve dhe komunitetit të biznesit.
- Institucionet kyçe që ndikojnë në klimën afariste do të fillojnë me publikimin e udhëzimeve zyrtare dhe obliguese-ligjore për zbatimin e ligjeve në sferën e tyre.
- Institucionet patjetër do të duhet të publikojnë të gjitha ligjet relevante, aktet nënligjore si dhe procedurat interne në ueb - faqen e tyre.
- Eliminimi i të gjitha dokumenteve të panevojshme që i kërkojnë institucionet gjatë procedurave administrative. Kështu do të zvogëlohen shpenzimet shtesë, kurse çmimi i përgjithshëm i shërbimeve do të potencohet qartë. Paraprakisht,

institucionet do ta konsultojnë komunitetin e biznesit rreth procedurave që u shkaktojnë problemet më të mëdha ose procedurat më të gjata.

- Tërësisht në formë elektronike do të jepen edhe 50 vërtetimet ose dokumentet e kërkuara më së shumti, kurse për çdo procedurë, në veçanti do të publikohen hapat në procedurë dhe se cilët nëpunës janë të obliguar që të veprojnë.

Qeveria do ta ndryshojë politikën e dënimit duke insistuar, që për bazë do ta ketë parandalimin. Shërbimet e inspektimit nuk do të jenë instrument për represion dhe presione politike. Përzgjedhja e subjekteve juridike për kontroll, do të realizohet përmes përzgjedhjes së rastësishme ose pas paraqitjes me argumente të forta. Për eliminimin ose uljen e shkallës së subjektivitetit gjatë realizimit të kontrollit inspektues, do të inkorporohet një regjistër publik i kontrolleve inspektuese, që i realizojnë organet dhe inspektimet shtetërore. Do të ketë së pari - paralajmërim për shkeljen e bërë; vetëm në rast të përsëritjes së tij - do të ketë dënim. Dënimet do të jenë proporcionale me të hyrat dhe nivelin e subjekteve afariste.

Qeveria do të ndihmojë në zhvillimin e ndërmarrjeve vendase, veçanërisht ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, përmes këtyre masave:

- Forcimit të kapacitetit financiar dhe kadrovik të Agjencisë për Përkrahjen e Sipërmarrjes, e qëllim që të arrihet delegimi i të drejtave dhe obligimeve për koordinim të zbatimit të politikave për zhvillimi e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM).
- Banka e Maqedonisë për Përkrahjen e Zhvillimit (BMPZh) do të kapitalizohet në mënyrë plotësuese me qëllim që të rris përkrahjen kredituese dhe aftësinë për realizimin e skemës garantuese.
- Krijimin e një këshilli ndërministror prej ministrive që kanë kompetenca në punën e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Këshilli do të jetë kompetent për koordinimin e aktiviteteve të kontraktuara për avancimin e punës së NVM.
- Sigurimin e një kontrolli të vërtetë të prodhimeve që importohen, me qëllim të parandalimit të konkurrencës jolojale si dhe praktikës që tregtarët vetëm formalisht të japin deklarata për harmonizim me certifikatën.
- Ulja e shpenzimeve të firmës për ndërmarrjet me më pak se 5 të punësuar me çka do të ulen edhe shpenzimet e punës dhe do të nxiten nismat për biznese personale.
- Ndihmë e drejtpërdrejtë këshillëdhënëse përmes Agjencisë për Përkrahjen e Sipërmarrjes në Republikën e Maqedonisë, e cila do të jetë një shërbim i vërtetë për bizneset e vogla.
- Krijimi i një skeme adekuate garantuese përmes BMPZh për kredi investuese dhe kredi për mjete qarkulluese për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.
- Vendosja e një mikrolinje kredituese për përkrahjen e start-up dhe mikro kompanive, si dhe linjave kredituese për projektet “Franshiza” dhe “Investime të përziera”.
- Themelimin e fondit investues për investime në start-up biznese dhe NVM me pjesëmarrje minimale të shtetit, ku përmes 51% do të jetë në pronësi private të subjekteve të interesuara private.
- Vendosja e një mekanizimi për përkrahje të projekteve investuese të ndërmarrjeve vendase deri në shumën prej 25% të përmbledhjes së shpenzimit të



përgjithshëm për investim si dhe shpenzimit bruto për çdo vend të ri të punës. Përkrahja do të realizohet përmes dy kanaleve: (a) përkrahjes së drejtpërdrejtë në shumë prej 1.000 deri në 2.000 euro në kundërvlerë me denarin, në bazë të shumës së pagës për çdo vend të ri të hapur të punës, ku punëdhënësi merr obligimin që të paguaj pagë bruto në periudhë prej 2 viteve; dhe (b) lirim nga pagesa e tatimit të fitimit dhe pronës në 5 vitet e ardhshme.

- Lehtësimi i punës së ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në mjediset rurale përmes financimit të projekteve infrastrukturore..

Qeveria do të përgatis edhe një strategji për zhvillim të turizmit aktiv aty ku është potenciali për zhvillim të fortë ekonomik lokal, si dhe hapjen e vendeve të reja dhe atyre më mirë të paguara të punës. Për këtë qëllim do të implementohet Ligji për planin hapësinor për ruajtjen e resurseve atraktive natyrore që janë kyçe për këtë turizëm; do të përkrahen aktivitetet për pastrimin e qendrave turistike, do të rregullohen marrëdhëniet pronësore dhe do të vendosen në përdorim pushimoret e fëmijëve dhe shtëpitë malore, etj.

Për zhvillimin e sipërmarrësisë, Qeveria do të mundësojë hapjen e qendrave afariste start-up në të gjitha komunat më të mëdha, në të cilat shteti do të sigurojë hapësirë afariste për më tepër komani të sapo themeluara, së bashku me infrastrukturë dhe shërbimet e përbashkëta (mirëmbajtje, arkivi, kontabiliteti etj.) të cilat do të jenë falas për pjesëmarrësit e qendrës.

Mundësia për themelimin e ndonjë lloji të veçantë të shoqërisë tregtare me shumë minimale të kryegjësë themelore prej 1 euro. Këto shoqëri tregtare do të kenë shenjim të caktuar, në vend të dukshëm, për secilin që do të bashkëpunojë me këtë lloj të subjektit afarist të dijë se kapitali i tij themelues është 1 euro.

Kompanive që do të investojnë, e që kanë nevojë të këtillë, do t'u jepet për shfrytëzim parcela të pashfrytëzuara të tokës shtetërore. Numri i parcelave që do të jepeshin për ndonjë firmë të veçantë, do të varet nga kushtet që i plotësojnë kompanitë (madhësia e investimit dhe numri i punësimeve të reja).

Qeveria do të propozojë heqjen e shpenzimeve gjatë importit të pajisjeve për projektet e reja që angazhojnë fuqi punëtore nëpër komunat jo mjaft të zhvilluara, si dhe për veprimtaritë që janë të bashkuara në klasterë. Njëherë, do të sigurohet përkrahje e drejtpërdrejtë financiare për përpunim shtesë më të madh të prodhimtarisë bujqësore primare. Do të stimulohet bashkimi i prodhuesve primar, si dhe kompanive të përpunimit që do të investojnë në kapacitetet dhe pajisjet për prodhimtari të produkteve me lëndë të pare vendase.

Shteti do të përkrah zhvillimin e ndërmarrjeve vendase edhe me reformat adekuate të furnizimeve publike. Do të rritet transparencja e tyre dhe do të eliminohet tenderët e rregulluar paraprakisht për kompani të favorizuara. Si pjesë shtesë:

- Institucionet publike do të bëjnë analizë të tregut të ofertës para se të shpallin tenderët. Nëse për nevojat e tyre ka zëvendësim adekuat (prodhim ose shërbim) që mund ta ofrojnë kompanitë vendase, atëherë vetë tenderi do të duhet të preferojë prodhime dhe shërbime të atilla.
- Ndërprerja e praktikës për favorizim politike të disa kompanive të njëjta që e ngufasin konkurrencën. Për këtë do të lehtësohet kriteri themelor (qarkullimi vjetor), si kusht për pjesëmarrje në tenderë sepse ai kryesisht keqpërdorej për eliminimin e konkurrencës.



- Gjithmonë kur është e mundur, pa u shkelur kualiteti i furnizimit, tenderët e mëdha do të ndahen në më tepër pjesë ku do të mund të konkurrojnë edhe NVM. Njëkohësisht do të kufizohet edhe numri i pjesëve ku mund të konkurrojnë një kompani.
- Do të zbatohet parimi i vlerës së parave (value for the money), e jo me automatizëm të pranohet çmimi më i ulët.
- Do të zvogëlohet asimetria informative e cila i godet NVM përmes thjeshtësimit të procedurave për konkurrim dhe qarkullim të shpejtë të informatave.

Rritja ekonomike varet nga investimet në shkencë dhe hulumtim, si dhe zhvillimin e teknologjive të reja dhe industrive me kthim më të madh të investimit. Për këtë qëllim, Qeveria do të financojë së paku 10 projekte hulumtuese në vit, të ofruara nga institucionet shkencore, e të pranueshme nga odat ekonomike në Maqedoni.

Do të përkrahjen aktivitetet shërbyese me vlerë më të madhe të shtuar (IT kompani, telekomunikime, arkitekturë, etj) përmes mbulimit deri në 50% të shërbimeve për pajisjet e domosdoshme për investimet e reja, deri në një shumë maksimale prej 50.000 euro. Qeveria do të propozojë lehtësime tatimore për të gjitha kompanitë e ITK të cilat eksportojnë softuer dhe shërbime si dhe uljen e tatimit të fitimit për informatikë dhe teknologji informatike në 5%. Me këtë do të mundësohen punësime të reja, rriten të hyrat devizore si dhe ndërtimi i kompanive të reja të ITK.

Në bashkëpunim me bashkësinë e ITK në Maqedoni, Qeveria do të financojë zgjidhje inovative, të cilat do ta rrisin efikasitetin e politikave në: 1) bujqësi, 2) arsim dhe 3) punët e brendshme

Qeveria do të përkrah hapjen e qendrës hulumtuese teknologjike-zhvillimore për shqyrtimin e përparësive të kompanive të vogla dhe të mesme të Maqedonisë në aspekt të atyre evropiane si dhe për eliminimin e segmenteve ku ato kanë ngecje, siç janë ambalazhimi, marketingu, respektimi i afateve për dorëzim, niveli i kualitetit, teknikat koinzistente të menaxhimit, etj. Do të rritet edhe shfrytëzimi i fondeve të jashtme për ndihmë teknike, si dhe ato që janë në dispozicion për ndërmarrjet vendase për vendosjen e proceseve të reja teknologjike, rritjen e prodhimit etj. Qeveria do të sigurojë linja për përkrahje financiare të ndërmarrjeve për lansimin e prodhimeve të reja si dhe dizajnit të ri prodhues, futjen e metodave moderne të prodhimit si dhe metodave për kontrollin e kualitetit, logjistikë dhe distribucion modern, si dhe marrjen e certifikatave për kualitet dhe promovimin e prodhimeve vendase.

Qeveria do të udhëheqë një politikë aktive dhe transparente të tërheqjes së drejtpërdrejtë të investimeve të jashtme. Do të stimulohet tërheqja e investimeve me një vlerë më të madhe të shtuar, që siguron lidhje me ndërmarrjet vendase. Në këtë drejtim, Qeveria do të publikojë një analizë të detajuar cost/benefit të investimeve dhe përfitimeve nga procesi i tërheqjes së kompanive të huaja deri më tani, veçanërisht atyre për ato që shfrytëzojnë ndihmë shtetërore.

Qeveria do të propozojë lehtësime tatimore për investime nga ana e qytetarëve që kanë shkuar për punë jashtë vendit. Për këtë qëllim do të shfrytëzohen mjete nga fondi investues për start-up biznese dhe NVM-së, si dhe skema garantuese e BMPZh-së.

## Mbrojtja sociale

Qëllimi kryesor i Qeverisë në sferën e politikës sociale është që deri në vitin në 2020 shkalla e varfërisë të ulet nën 16%. Në sferën e politikës sociale do të inkorporohen masa që do të nxjerrin shfrytëzuesit nga varfëria, veçanërisht do t'i kushtohet vëmendje sigurimit të transparencës së këtij sistemi.

Qeveria do të vendos një rrjet funksional të institucioneve për mbrojtje sociale, të afërt me qytetarët dhe adekuate për nevojat e tyre, ku një pjesë e kompetencave do të transferohet edhe te vetëqeverisja lokale, e cila është më e afërt me ta dhe më shpejtë përshtatet me nevojat e tyre.

Rrjeti do të përfshijë shërbime sociale për përkrahjen dhe kujdes të veçantë për personat e moshuar, qendrave për kujdes dhe inkuadrim, qendrave për personat me nevoja të veçante, bashkësive për strehimin e personave me nevoja të veçanta edhe pas moshës 26 vjeç, shërbime për mbrojtje nga dhuna në bazë gjinore, si dhe shërbime për mbrojtje të grupeve tjera të qytetarëve që kanë nevojë, e që ballafaqohen me ndonjë rrezik social.

Qeveria do të vendos sistemin e tetë agjencive rajonale për pagesën e të drejtave materiale të sistemit për mbrojtje sociale. Njëherë, do të inkorporohet parimi i punëtorit social të familjes, i afërt me qytetarët që do të punojë për parandalimin e intervenimit. Numri i familjeve të përfshira nga ana e çdo punëtorit social do të parashihet sipas standardeve dhe normativave që për herë të parë garantojnë kualitet të punës sociale në Maqedoni, si për qytetarët, ashtu edhe për punëtorët profesional.

Qeveria do të ofrojë zgjidhje për problemin e punëtorëve të falimentuar dhe do të sigurojë kompensim në para për të gjitha kategoritë e punëtorëve të falimentuar që kanë së paku nga 15 vjet stazh dhe moshë prej 52 vjeç për gratë dhe 55 vjeç për burrat.

Qeveria do të propozojë uljen e kompensimit të përmbaruesve dhe borxhlinjve, të cilët janë raste sociale kurse përmbarimi do të jetë edhe pa pagesën e tarifës së përmbaruesit. Do të futen edhe kufizime sipas të cilave taksat dhe shpenzimet gjyqësore nuk do të mund të jenë më të larta se 20% nga kontesti, kurse normat e interesit kumulative nuk guxon të jetë më i lartë se shuma e kryegjësë, për të gjitha familjet, që kanë të hyra mesatare mujore më pak se një pagë mesatare.

Në sferën e politikës sociale Qeveria do të zbatojë edhe këto masa dhe aktivitete:

- Inkorporimin e Programit për të hyra minimale adekuate.
- Inkorporimin e kartelës sociale - debitore - Solidariteti.
- Ndryshime ligjore me qëllim të vendosjes të së drejtës për shfrytëzim, e jo për pronësi, të banesave sociale. Banesat sociale do të rriten në bashkësi kolektive banesore që do të menaxhohen nga vetëqeverisja lokale. Të drejtë për shfrytëzim do të kenë edhe qytetarët të cilët janë në sistemin e mbrojtjes sociale dhe qytetarë me të hyra të ulëta, si dhe të rinjtë dhe çiftet, por edhe persona me pengesa që nuk posedojnë pronë tjetër.
- Hapja e bujtinave dhe punkteve për ushqim për të pastrehët, në bashkëpunim me shoqatat nacionale dhe lokale të qytetarëve me të gjitha komunitatet ku ka nevojë.

Në drejtim të sistemit pensional, Qeveria do ta stabilizojë Fondin për Sigurim Pensional dhe invalidor si dhe do të garantojë pagesë të rregullt dhe të qëndrueshme të pensioneve. Harmonizimi i pensioneve do të bëhet dy herë në vit, kurse do të futet

mundësia për pensionim të parakohshëm deri në maksimum 5 vjet para realizimit të së drejtës për pension, me një zvogëlim proporcional të kompensimit për pension.

Qeveria do të veprojë me propozim për futje të pensionit social shtetëror për çdo person prej mbi 65 vjeç, i cili në 20 vitet e fundit ka jetuar në territorin e Republikës së Maqedonisë dhe që nuk ka realizuar të drejtën e pensionit të pleqërisë.

Do të modernizohen shërbimet shëndetësore si dhe ato për përkujdesjen e personave të moshuar dhe të sëmurë, në drejtim të përmirësimit të qasjes së tyre, në pajtim me kërkesat dhe nevojat e tyre konkrete si për gratë ashtu edhe për burrat. Do të vendosim subvencionimin e strehimit në azilet e pleqve për pensionistët me të hyra të vogla pa përkrahje të familjes si dhe ata pa ndonjë pronë.

Qeveria do të iniciojë krijimin e bashkësive të pensionistëve, duke bërë një strehim të organizuar të personave të moshuar, në lagje ku banimi do të sigurohet me çmime më të volitshme, me shërbime mjekësore në dispozicion, me oferta të volitshme të prodhimeve ushqimore.

Qeveria do të përkrah familjet me nga një prind duke mundësuar orar fleksibil të punës për prindin si dhe lirim nga një pjesë e obligimeve publike (taksë, transport publik, kompensim për çerdhe) të familjeve me nga një prind, që kanë pagë më të ulët se paga mesatare. Do të krijohet Fond shtetëror për pagesën e kujdesit ligjor për fëmijët. Në rast se prindi nuk e paguan kujdesin në kohë, Fondi do të paguaj mjetet të cilat më pas do t'i inkasojë nga mos paguesi. Me këtë, do të garantohet pagesë në kohë e të gjitha kujdeseve ligjore nga ana e prindërve ndaj fëmijëve të tyre.

Në mënyrë shtesë, do të ofrohen shërbime falas për familjet me nga një prind me të hyra nën mesataren, në nivel lokal për përkrahjen gjatë funksionimit të përditshëm të këtyre qytetarëve.

Qeveria do të vendos një program për përkrahje individuale të fëmijëve nga familjet që janë në sistemin e mbrojtjes sociale dhe fëmijëve me të hyra të ulëta, si përkrahje e familjeve që janë me rrezik të madh. Gjithashtu, do të sigurohet një rrjet i familjeve për kujdes profesional të cilëve u rregullohet marrëdhënia e punës në marrëveshje me shtetin.

Do të promovohen shtëpi të vogla rajonale në grupe, për fëmijët me rrezik social që nuk lejon familje për përkujdesje. Intervenimet dhe trajtimi do të jenë në drejtim të ndërtimit të kapaciteteve dhe shkathtësive të fëmijës përmes qasjes së veçantë për përfshirje të sërishme në shoqëri.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë do ta përmirësojë sistemin e mbrojtjes së personave me nevoja të veçanta, e tërë kjo në konsultim me organizatat joqeveritare dhe ato profesionale. Mes tjerash, ajo do të nënkuptojë:

- Rritjen e shumës së mjeteve për mbrojtjen e të drejtave të personave me nevoja të veçanta për 50% gjatë periudhës së mandatit.
- Sigurimi i së drejtës për shtojca të veçanta deri në 26 vjet me automatizëm të kalojë në një të drejtë dhe kujdes nga ndonjë person tjetër, e cila edhe pse është paraparë me Ligjin për mbrojtje sociale, nuk ka funksionuar në praktikë.
- Personat që shfrytëzojnë asistencë të veçantë financiare pas arritjes së moshës 18 vjeçare do të fitojnë mundësinë që të realizojnë edhe të drejtën për ndihmë të përhershme financiare.

- Shpenzimi i parave nga fondi i veçantë për punësimin e personave me nevoja të veçanta në APRM do të jetë transparent dhe publik.
- Riorganizimi i qendrave ditore për personat me pengesa. Do të përpilohen norma të definuar qartë për llojin e grupeve sipas kategorisë së përfshirjes, sipas moshës, sipas numrit që duhet ta ketë një grup. Do të miratohen edhe plane dhe programe të veçanta për aktivitetet e grupeve në Qendrat ditore, sipas kategorive dhe sferave të përpunimit të programeve. Do të miratohen edhe norma për kuadër të domosdoshëm profesional që do të punojë në Qendrat ditore, si dhe për resurset e nevojshme teknike.
- Me ligj do të garantohet përfshirja e edukatorit special në çdo çerdhe dhe shkollë ku ka fëmijë me aftësi të veçanta, me qëllim të përkrahjes adekuate të fëmijëve dhe familjeve.
- Refundim në kohë i kontributeve për sigurim pensional dhe shëndetësor në bazë të punësimit të shoqatave për mbrojtje.
- Respektimi i kuotave për punësimin e personave me nevoja të veçanta në administratën publike, duke vlerësuar mendimet personale të dhëna nga qendrat për punë sociale, për prioritet gjatë punësimit.
- Komisioni mjekësor do të vizitojë në shtëpi personat të cilëve duhet t'u sigurohet shtesë për mobilitet, verbëri dhe shurdhim, e që veç më kanë diagnozë të konstatuar.
- Sigurimi i së drejtës për asistencë financiare edhe për personat me vështirësi më të mëdha intelektuale.
- Krijimi i një sistemi për vlerësimin e nevojave specifike (kategorizim) i fëmijëve me pengesa në bazë të Klasifikimit ndërkombëtar të funksionimit. Modeli do të ketë për qëllim që në aspekt funksional të përcaktojë karakteristikat specifike të fëmijëve me nevoja të veçanta, por jo sipas asaj që nuk munden ta bëjnë, por sipas aftësive të tyre të tjera, respektivisht sipas asaj që ata mund ta bëjnë (vlerësim funksional).
- Me ndryshime ligjore do të sigurohet që orari i shkurtuar i punës për prindërit e fëmijëve me pengesa, të vazhdohet edhe pasi të kenë mbushur 26 vjeç.
- Hapja e qendrave për zhvillim të hershëm të fëmijëve të cilat do t'i përfshijnë fëmijët e moshës së hershme, menjëherë pas lindjes, që si funksion themelor do ta kenë zhvillimin e aftësive të fëmijëve me ndonjë lloj vështirësi të veçantë (paralizë cerebrale, autizëm, etj.).

Qeveria do të financojë hapjen e bujtinave dhe punkteve për ushqim për të pas-trehët, në bashkëpunim me shoqatat nacionale dhe lokale të qytetarëve, në të gjitha komunat ku ka nevojë. Do të përpilohet një ligj, sipas modelit të Francës, i cili do të mundësojë dhurimin e ushqimit nga ana e supermarketëve, restoranteve, prodhuesve dhe distributorëve.

## **Republika e Maqedonisë - anëtare e NATO-s dhe Bashkimit Evropian**

Anëtarësimi në NATO dhe BE janë përcaktime tona strategjike. Ato nënkuptojnë edhe një standard më të mirë ligje të modernizuara, paga më të mëdha, siguri të shtetit, siguri te qytetarët, investime të reja, lëvizje të lirë. Ato janë edhe garanci për pronësinë private, lirinë dhe pavarësinë e njeriut, siguri juridike dhe ekonomike. Anëtarësimi në NATO dhe në BE nënkupton edhe fundin e gjyqësisë dhe prokurorisë partiake, medimeve dhe oligarkëve partiak.

Prioritet i yni shtetëror është që Republika e Maqedonisë të bëhet subjekt ndër-kombëtar sovran, i respektuar dhe me prosperitet. Qeveria ka një vizion të qartë për realizimin e qëllimeve strategjike: Zhvillim i gjithanshëm i marrëdhënieve me fqinjët dhe integrimin e shtetit në strukturat evropiane dhe euroatlantike.

Përcaktimet e nënvizuara strategjike të Republikës së Maqedonisë, do të realizohen vetëm me iniciativa dhe hapa konkret të një politike të jashtme të menduar mirë, reale dhe e udhëhequr në mënyrë profesionale dhe shtetërore. Vetëm kështu, do të tejkalohen sfidat dhe kërcënimet në drejtim të zhvillimit dhe sigurisë. Vetëm politika e këtillë mund të paraqesë një faktor real gjatë promovimit të interesave tona strategjike në plan global.

Raporti i fundit i Komisionit Evropian, në tërësi bazohet në konstatimet e raportit të ekspertëve të ekipit të Rajnhard Pribe. Për gjendjen në Republikën e Maqedonisë padyshim potencohet fakti se shteti është mbuluar nga partia në pushtet dhe se me të sundon krimi i organizuar, korrupsioni dhe shkelja masive e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë, do të filloj me një aktivitet serioz dhe të fuqishëm ndërkombëtar me qëllim që Maqedonia të fitojë mundësinë për të filluar negociatat me BE-në deri në fund të vitit 2017. Ky aktivitet do të ketë rezultat vetëm nëse pasohet nga një agjendë e brendshme reformuese. Për këto arsye, vendimet tona strategjike do të bazohen në rekomandimet e Raportit të Pribes dhe rekomandimeve urgjente të BE-së, si dhe rekomandimeve të dialogut aderues në nivel të lartë me BE-në. Në këtë drejtim, Qeveria do të fillojë me një luftë vendimtare dhe josedektive me krimin e organizuar dhe korrupsionin, reforma themelore për sundimin e së drejtës dhe ndërtimin e institucioneve të pavarura, të cilat do të sigurojnë barazinë e të gjithë qytetarëve para Kushtetutës dhe ligjeve në Republikën e Maqedonisë.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë do të propozojë deri te Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, një Strategji nacionale për politikë të jashtme të Republikës së Maqedonisë. Qëllimi do të jetë që kjo Strategji të sigurojë një debat të gjerë dhe një përkrahje konsensuale. Temat e mëdha të politikës së jashtme vazhdimisht do të debatohen në shtëpinë ligjvënëse dhe për to do të kërkojmë pëlqim shumëpartiak.

Në bazë të kësaj Strategjie, Qeveria do ta transformojë pjesëmarrjen e Republikës së Maqedonisë nga një pjesëmarrës pasiv në një faktor aktiv në procesin e Berlinit si dhe do të angazhohemi edhe në zbatimin e Agjendës për lidhjen e rajonit e cila është pjesë e saj.

Është e qartë se integrimet, zhvillimi dhe siguria e shtetit fuqishëm varet edhe nga marrëdhëniet e mira dhe produktive fqinjësore. Qeveria e Republikës së Maqedonisë do të imponojë një dinamikë të re të marrëdhënieve ndaj fqinjëve të vet, duke insistuar në një bashkëpunim konstruktiv në të gjitha sferat në planin bilateral dhe rajonal.

Qeveria do të investojë të gjitha potencialet shtetërore për të kthyer klimën pozitive

dhe besimin në marrëdhëniet, sikurse me BE-në dhe me ShBA-të, ashtu edhe me fqinjët e saj për ta kthyer Republikën e Maqedonisë në pozitën e liderit rajonal.

Qeveria nuk do të lejojë që në plan ndërkombëtar, cilit do qytetar të Republikës së Maqedonisë t'i kontestohet përcaktimi i tij etnik, kulturor, gjuhësor, fetar, gjinor ose cili do përcaktim tjetër. Ky vizion është në përputhje me të gjitha dobitë civilizuese. Do të japin përpjekje maksimale për realizimin e të njëjtës mirëqenie sikur me fqinjët ashtu edhe për rajonin më gjerë në Evropë.

Duke u nisur nga Kushtetua e Republikës së Maqedonisë, për çështjet me interes më të lartë shtetëror dhe nacional, Qeveria në mënyrë aktive do të ndërtojë një konsensus me të gjithë faktorët relevant në shtet. Ajo realisht do të angazhohet për tejkalimin e kontestit të imponuar nga ana e Greqisë, por nuk do të pranojë kurrfarë bisedimesh për çështjet e identitetit. Për çdo zgjidhje të mundshme do të konsultohen qytetarët.

Qeveria asnjëherë nuk do të lejojë tentativat për ndryshimin e identitetit nacional, gjuhësor dhe kulturor të popullit maqedonas, si dhe të cilës do bashkësi etnike në Republikën e Maqedonisë. Qeveria do të fokusohet në bashkëpunimin rajonal dhe atë ndër fqinjësor. Kështu, për përmirësimin e zhvillimit dhe stabilitetit rajonal, do të forcojmë shkëmbimin dhe bashkëpunimin e gjithanshëm me fqinjët në të gjitha sferat për pjesëmarrje aktive dhe ndikimit në të gjitha iniciativat rajonale, qasjes serioze dhe aktive në projektet e infrastrukturës, energjetikës dhe telekomunikimit, zonave zhvillimore tejkufitare si përkrahe për zhvillimin e rajoneve rurale, respektivisht atyre kufitare në Republikën e Maqedonisë (duke shfrytëzuar fondet e BE-së), ripërtëritjen e iniciativave për vendkalime të reja kufitare me vendet fqinje dhe promovimin e vendkalimeve të reja ndërkombëtare dhe lokale për popullsinë rreth kufitare.

Qeveria do të kujdeset edhe për gjendjet me pakicën nacionale maqedonase në vendet fqinje përmes Ministrisë së Punëve të Jashtme. Do ta ripërtërijmë përkrahjen për arsimin, kulturën dhe gjuhën, përmes librave, literaturës, mësimdhënësve, lektorëve dhe shfaqjeve, gjithsesi pa përzierje në punët e brendshme të fqinjëve si dhe duke i respektuar në tërësi ata. Do t'i forcojmë lidhjet me diasporën edhe përmes financimit të orëve në gjuhën amtare në PDK në qytetet ku do të shprehet interes për një gjë të tillë. Do të ripërtërihen edhe lektoratet për gjuhën maqedonase, literaturën dhe kulturën që ishin të anashkaluar dhe të harruara nga shteti gjatë këtyre viteve.

Lidhjet me mërgimtarët tanë do të përmirësohen edhe përmes a.q. "konsullatave virtuale" ku të gjitha shërbimet e domosdoshme për ta do të jenë në dispozicion, së bashku me informatat e domosdoshme. Secila ambasadë ose konsullatë patjetër do të duhet të ketë sistem për kontakt efikas dhe në dispozicion për kontakt dhe përgjigje.

Njëherë, do të revitalizojmë procesin e lënë anash të këshillimeve juridike të diasporës tonë me fokus të standardeve ndërkombëtare dhe përcjelljes së vendimeve të instancave ndërkombëtare, e në veçanti të Gjykatës evropiane për të drejtat e njeriut.

Në pajtim me qëllimet strategjike dhe analizës së gjendjes aktuale, Qeveria do të krijojë një rrjet të ri shtetëror që do të jetë politikisht dhe financiarisht optimal, e para se gjithash me efikasitet diplomatik. Do të përforcohen ambasadat në vendet me rëndësi strategjike për Republikën e Maqedonisë, kurse për përzgjedhjen e kuadrit diplomatik do të bazohet në respektimin e kualitetit profesional dhe njerëzor. Politika e jashtme e Republikës së Maqedonisë do të ketë qëllime të qarta, koordinim të definuar dhe një rrjet profesional diplomatik. Qeveria do të përpilojë plan për blerjen e objekteve në 4 vitet e ardhshme për nevojat e domosdoshme të PDK.



Qasja jonë parasheh zhvillimin e kulturës së debatit dhe një transparencë të plotë të procesit të aderimit në Bashkimin Evropian. Që në vitin e parë do të iniciohet një proces i emërimit të negocuesit kryesor me BE-në me mundësi që të zgjidhet me konsensus ndërmjet pushtetit dhe opozitës, që do të fillojë me përpilimin e pozitave negocuese për kapitullin e gjyqësisë dhe të drejtave themelore (23) si dhe për drejtësinë, lirinë dhe sigurinë (24).

Zbatimi i Strategjisë për Evropën Juglindore 2020 do të fitojë vendin e miratuar dhe për të do të ndahen edhe mjetet adekuate. Si pjesë e iniciativave të reja rajonale të Republikës së Maqedonisë, do të propozojmë edhe vendosjen e një Ombudsmeni rajonal gjinor i cili do të kujdeset për realizimin e politikave për mundësi të barabarta të grave dhe burrave në Ballkanin perëndimor si dhe krijimin e Akademisë politike rajonale për ndërtimin e kapaciteteve të partive politike, të financuara përmes IPA-s, me ç'rast do ta propozojmë Maqedoninë për nikoqir të saj.

Përkrahja financiare Evropiane do të vihet në funksion të evropianizimit të tërë shtetit. IPA nuk do të jetë instrument me të cilin përgatitet vetëm administrate publike për zbatimin e negociatave për anëtarësim në BE, por do të ndërtojë kapacitetet e të gjithë faktorëve në shoqëri. Ajo nënkupton se krahas institucioneve shtetërore, mjete patjetër duhet të sigurohen edhe për komunat, shkollat, sindikatat, grupet e marginalizuara, punëdhënësit, të papunët, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, organizatat qytetare, universitetet dhe institucionet hulumtuese, madje edhe për grupet joformale të qytetarëve.

Qeveria menjëherë do të përpilojë një raport të plotë dhe publik në të cilin do të publikojmë shumën e saktë të mjeteve të humbura (pashfrytëzuara) nga fondet e BE-së dhe me këtë do të hapim procesin e transparencës së rritur gjatë udhëheqjes dhe shfrytëzimit të tyre. Në koordinim me Komisionin Evropian do të ofrojmë instrumente për shfrytëzimin më të shpejtë dhe më të plotë të fondeve të BE-së.

Do të formojmë një ekip të veçantë që do të përkushtohet në shfrytëzimin e mjeteve dhe ofertave që i ofron korniza investuese për Ballkanin perëndimor (ËBIF) dhe ndihmën për përpilimin e projekteve infrastrukturore në rajonet evropiane (JASPERS).

Qeveria do të investojë në ekipe që do të punojnë si konsulent të kornizës së BE-së, përmes trajnimit të tyre jashtë vendit. Ata do t'i ndihmojnë grupeve të caktuara në përgatitjen e projekteve evropiane (p.sh për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme për pjesëmarrje në KOSME; për studentët, nxënësit, profesorët, universitetet për pjesëmarrje në Erasmus plus; për qendrat hulumtuese, universitetet, ndërmarrjet, inovatorët për pjesëmarrje në Horizont 2020; për shtëpitë e produksioneve dhe medimeve për pjesëmarrje në programin për Medime; për inovacionet sociale të shoqërisë civile, komunat, ndërmarrjet publike, për pjesëmarrje në programin EaSi; për qendrat kulturore, shtëpitë e produksionit, artistët, teatrot, për pjesëmarrje në programin për Kulturë; për Drejtorinë doganore për pjesëmarrje në programin Doganë; për drejtorinë e të Ardhurave publike për pjesëmarrje në programin Fiskalis; për kominat dhe rajonet për pjesëmarrje në programin e Mekanizimit për mbrojtje civile, etj.).

Të gjitha ata që do të mund të tërheqin mjete shtesë nga fondet e tjera evropiane, do të përkrahen me masa adekuate - që nga aplikimi e deri te realizimi. Për këtë qëllim si dhe për shfrytëzimin më të lehtë të fondeve evropiane, do të vendoset një a.q Fond për zhvillim, i cili do të ndërtojë kapacitetet e shfrytëzuesve të ardhshëm të mjeteve evropiane, do të sigurojë kofinancim (që është edhe problemi kryesor për momentin, kur bëhet fjalë për IPA si dhe për programet e tjera evropiane si Horizont, COSME, EaSI, Erasmus plus, Evropa e qytetarëve, Industritë kreative, Medimet, etj.). Fondi do të lid-



het edhe me Masat aktive për punësim në Republikën e Maqedonisë, veçanërisht në pjesën e kofinancimit si dhe me Garancinë për të rinjtë.

Qeveria do ta nxis edhe të ashtuquajturin vaçer sistem, në veçanti i përshtatshëm për bujqit gjatë shfrytëzimit të mjeteve nga IPARD. Njëherë, në vend që të presim që bujqit të shkruajnë projekte, qeveria do të sigurojë mjete për konsulentë të cilët do të duhet t'i ndihmojnë kësaj kategorie të njerëzve. Bujqit do të fitojnë vaçer me të cilin do të paguajnë konsulentët, kurse ai/ajo do të duhet që të jetë në dispozicion 24/7, deri në rrumbullakimin e projektit .

## Politika e mbrojtjes në kontekst të NATO-s

Sektori i mbrojtjes ishte udhëheqës i aktiviteteve reformuese të Republikës së Maqedonisë, në arritjen e qëllimit strategjik të shtetit, anëtarësimit në NATO. Si iniciues dhe lider i grupit të Adriatikut, Republika e Maqedonisë sot është shteti i vetëm i këtij grupi, i cili ende nuk është anëtar i NATO-s.

Anëtarësimi në NATO do të kthehet në krye të prioriteteve të Republikës së Maqedonisë. Kjo është një përcaktim strategjik i shtetit dhe një qëllim shumëvjeçar konsensual i të gjithë qytetarëve të saj. Ruajtja e sovranitetit, integritetit territorial dhe karakterit unitar të Republikës së Maqedonisë, përmes ruajtjes së stabilitetit dhe sigurisë, si dhe pjesëmarrjes së shtetit në sistemet kolektive të mbrojtjes, janë parimet themelore ndaj të cilëve do të përkushtohemi. Anëtarësimi në NATO nuk nënkupton vetëm sigurinë dhe stabilitetin e shtetit. Ajo është një bazë dhe parakusht kryesor për zhvillimin ekonomik dhe investimet e pritura të huaja.

Qasja e Qeverisë do të nënkuptojë reforma serioze në sistemin e mbrojtjes, në pajtim me Konceptin strategjik për zhvillimin e NATO-s 2010-2020. Kontributi dhe pjesëmarrja e Republikës së Maqedonisë në misionet e udhëhequra nga NATO dhe OKB edhe më tutje mbeten prioritet i lartë. Do të afirmojmë pjesëmarrjen e deritanishme në potencialet ushtarake të Republikës së Maqedonisë në operacionet e NATO-s për parandalimin dhe tejkalimin e konflikteve në botë. Ajo e radhit shtetin në faktorët e stabilitetit të Evropës Juglindore.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë do të ndryshojnë raportin ndaj financimit të sigurisë dhe mbrojtjes. Do të fokusohemi në zhvillimin e aftësive shpërndarëse dhe të qëndrueshme si dhe interoperabilitetit, të cilat priten nga një vend i ardhshëm anëtar i NATO-s. Do të propozojmë një zgjidhje të veçantë ligjore, në pajtim me Planin afatgjatë për zhvillimin e mbrojtjes, për sigurimin e mjeteve për mbrojtjen në shumë prej 2.3%-2.6% nga BPV. Kjo shumë do të arrihet në mënyrë sukcesive, në pajtim me fuqinë ekonomike dhe zhvillimin shtetëror në periudhën e ardhshme. Imperativi ynë do të jetë realizimi i mjeteve të ndara buxhetore, përmes kthimit dhe krijimit të kushteve të nevojshme për zbatimin dhe implementimin e plotë të PPBS - Sistemit të Planifikimit, programimit dhe realizimit shumëvjeçar të buxhetit (*Planning, Programming Budgeting System*). Në kuadër të kësaj metodologjie, tendenca jonë për ndarjen e kategorive buxhetore do të jetë, në fakt, siç është projektuar në fillim: 50% për personelin; 30% për operacionet, trajnimin dhe mirëmbajtjen; dhe 20% për pajisjen dhe modernizimin e ARM-së. Do të sigurojmë një strukturë financiare dhe mjete të nevojshme për mbulimin dhe rritjen e shpenzimeve për misionet tona jashtë vendit, në pajtim me Konceptin e NATO-s për “mbrojtje e mençur”, si dhe me Konceptin Strategjik nga viti 2010 si dhe me rekomandimet e Samitit të NATO-s në Uels në vitin 2014.

Qeveria do të japë përkrahje për konceptin e një armate të vogël dhe profesionale me intencë për krijimin e një strukture të përbashkët e të inkuorporuar të personelit të ARM-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes - “staff structure”, përmes zbatimit të një analize tërësisht funksionale. Ajo është parakusht për efikasitetin e detyrave, obligimeve të punës, funksioneve dhe përgjegjësisë, e me qëllim që të vendoset një sistem kualitativ i kontrollit civil të armatës, si një prej parimeve themelore demokratike.

Do të zbatojmë një departizim të plotë të Armatës dhe MM, përmes sigurimit të një sistemi efikas të menaxhimit me resurset njerëzore, të bazuar në profesionalizmin e personelit. Njëra prej shtyllave të këtij sistemi është ngritja e standardit të të punë-

suarve, motivimit dhe tërheqjes së personelit. Një prej prioriteteve kyçe në pjesën e menaxhimit me personelin është miratimi i Konceptit për lëvizje në karrierë, që është në tërësi i lënë anash në MM dhe ARM, e që ka për qëllim vendosjen e një strukture piramidale të personelit ushtarak.

Qeveria do të ofrojë një plan të qartë për statusin e ushtarëve profesional. Në pajtim me rregullativën ekzistuese ligjore, ushtarët profesional janë në shërbim të Ministrisë së Mbrojtjes deri në moshën 45 vjeçare. Pas kësaj periudhe, me vendim të Qeverisë dhe në marrëveshje me organet e tjera shtetërore, e në pajtim me nevojat e tyre, Ministria e Mbrojtjes do t'u sigurojë ushtarëve profesional, punësim te një punëdhënës tjetër, organ shtetëror, ndërmarrje publike, institucion publik, njësi e vetëqeverisjes lokale dhe Qytetin e Shkupit, fonde, agjenci, ente dhe subjekte tjera juridike të themeluara me ligj, pa shpallje për vendin e punës, me transferim dhe lidhjes së marrëveshjes së punës, në një vend pune që i përgjigjet përgatitjes së tyre profesionale, respektivisht kualifikimit të tyre.

Qeveria gjithashtu do të promovojë edhe Konceptin e ri të strukturës rezerve, të vogël dhe efikase - rezervë aktive. Kjo paraqet edhe një prej opsioneve për zgjidhjen e statusit të ushtarëve profesional pas moshës 45 vjeçare.

Njëra prej detyrave të para do të jetë revizioni i Planit afatgjatë për zhvillimin e mbrojtjes - 2014-2025, si dokument bazë për realizimin e reformave. Do të realizojmë një revizion të dokumenteve strategjike për reformat në sektorin e mbrojtjes, sipas standardeve të NATO-s, si dhe sfidave dhe nevojave të reja.

Do të bëjmë revizion të Strategjisë për zhvillimin e sistemit global të komunikimit-informimit në MM dhe ARM dhe do të vazhdojmë me realizimin e infrastrukturës optike të telekomunikimit, sistemin e menaxhimit të dokumentacionit, sistemin logjistik të informimit, sistemin për planifikimin, programimin dhe realizimin e buxhetit, sistemin e trajnimit të bazuar në kompjuter si dhe projekte të tjera.

Do të bëjmë revizionin e Planit ekzistues për divestimin e objekteve jo esenciale në MM dhe ARM. Procesi përfshin koordinimin e MM me të gjithë subjektet civile të involvuara në divestimin e objekteve jo esenciale - organet shtetërore, institucionet dhe organet e vetëqeverisjes lokale.

Me projektin për modernizimin dhe pajisjen e ARM-së, Qeveria do të investojë në furnizimin me helikopter të ri dhe servisim të fluturakeve ekzistuese, automjeteve motorike civile, transportuesit e blinduar, për nevojat e misioneve tona jashtë vendit si dhe sistemit taktik komunikues-informativ për batalionin e mesëm të këmbësisë, të deklaruar për pjesëmarrje në misionet jashtë vendit.

Një prej prioriteteve është edhe përgatitja profesionale dhe trajnimi i pjesëtarëve të ARM-së - pjesëmarrës në misionet ndërkombëtare ushtarake dhe njësisive të tyre, në të gjitha aspektet, me theks të veçantë për segmentin social, shëndetësor dhe atë të sigurisë së personelit i cili merr pjesë në ato misione.

Koncepti i ri për zgjidhjen e çështjes banesore të personelit të ARM-së dhe MM do ta definojë dhe rivendos politikën banesore në ARM. Ky koncept, para se gjithash, do të jetë real dhe i qëndrueshëm ku realizimi i tij do të nënkuptojë plotësimin e nevojave dhe interesave të ARM-së nga aspekti i realizimit profesional të funksioneve dhe detyrave të institucioneve. Koncepti i këtillë do të nënkuptojë edhe plotësimin e nevojave individuale të pjesëtarëve të ARM-së në aspekt të zgjidhjes së çështjes banesore.

## Ndërtojmë një shoqëri për të gjithë

Disa politikan të caktuar gjatë viteve të kaluara zgjodhën që të udhëheqin politika të ndarjes dhe shkaktimit të konflikteve ku njerëzit i ndanë në “të tanë” dhe “të tuaj”. Kjo është një politikë që ndërton të kaluarën e jo të ardhmen. Dallimet kulturore dhe etnike u bënë instrument për luftë dhe keqpërdorime politike. Konfrontimet e rritën dallimin në mes të bashkësive të ndryshme etnike. E forcuan edhe mosdurimin ndërmjet besimtarëve. U stimulua edhe mosdurimi ndaj grupeve shoqërore minoritare ose të marginalizuara, sikurse ndaj pjesëtarëve të LGBT popullatës, me çka shkaktoi madhe edhe disa forma të dhunës grupore ose individuale ndaj tyre, me grupe dhe individ ekstremist.

Qeveria do të udhëheq një politikë me të cilën Maqedonia do të ndërtohet si një shtet qytetar i të gjithëve që jetojnë në të. Maqedonas, Shqiptarë, Turq, Serb, Vllah, Romë, Boshnjak dhe të gjitha bashkësitë me të vogla. Do të ndërtojmë një shoqëri multikulturore në drejtim të një komunikimi më të madh interkulturor dhe ndërtimit të frymës së respektimit dhe pluralizmit politik. Do të punojmë edhe për uljen e dallimeve etnike, sociale dhe ekonomike ndërmjet bashkësive përmes projekteve me qëllime integruese dhe përmes investimit në shtete neutrale.

Do të përkrahim politikën gjuhësore në pajtim me nevojat dhe interesat e qytetarëve, bashkësive të ndryshme etnike dhe të tërë shtetit. Në këtë drejtim, Qeveria do të propozojë zgjidhje ligjore për përdorimin e gjuhëve, me të cilat do të zgjerohet përdorimi i gjuhës zyrtare që e flasin së paku 20% e qytetarëve, respektivisht gjuhës shqipe, në kudër të përcaktuar me Amendamentin V të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë. Ligji do të zgjerojë edhe përdorimin e obligimeve të institucioneve dhe do të rris mundësitë që qytetarët të komunikojnë me institucionet shtetërore në gjuhën e tyre amtare dhe me këtë më lehtë dhe më efikas të realizojnë të drejtat e tyre kushtetuese. Njëherë, ligji në tërësi do ta garantojë përdorimin adekuat të gjuhës maqedonase, por edhe të gjuhëve tjera që janë në përdorim zyrtar në njësi të caktuara të vetëqeverisjes lokale (turke, rome, serbe, vllahe dhe boshnjake). Për këtë qëllim, Qeveria do të formojë qendër gjuhësore dhe inspektorat përkatës.

Qëllimi ynë kryesor dhe i përbashkët është ndërtimi i një shoqërie tolerante. Për këtë arsye do të përkrahim programe të cilat, së bashku me masat në arsim, politikë sociale dhe zhvillimin e mëtejshëm kulturor, duhet t'i lirojë të rinjtë nga kthetrat etnike dhe nga paragjykimet në mes vete, duke mundësuar një komunikim mes vete, me të cilin, para se gjithash do të respektohen në mënyrë të ndërsjellë. Vetëm përmes dialogut mundemi që të kuptohemi. Vetëm mirëkuptimi i ndërsjellë mund të na mbrojë nga mospajtimet etnike. Shoqëria mund të ndërtohet duke u kujdesur për kulturën tonë, por edhe duke i njohur vlerat e ndryshme kulturore, të të tjerëve.

Vendi i parë ku duhet të ndërtohen vlerat e një shoqërie të përbashkët janë çerdhet e fëmijëve dhe shkollat. Për këtë qëllim, do të inkorporojmë elemente të njoftimit multikulturor, për të gjithë fëmijët që në moshën më të hershme, përmes projekteve dhe aktiviteteve që zhvillojnë një ndjenjë të lirisë, tolerancës dhe bashkëjetesës. Do të shfrytëzohen praktikat e projekteve të suksesshme për këtë shkallë të arsimimit. Do të stimulohen projektet për shoqërim multikulturor dhe komunikim në mes gjuhëve të ndryshme edhe në shkallët më të larta arsimore.

Nuk do të krijojmë kulturë etnocentrike, të mbyllur në katër muret e përkatësisë personale etnike. Dëshirojmë një shtet në të cilin kulturat do të bashkëpunojnë, do të plotësohen dhe mes vete do të pasurohen. Prej kësaj përbëhet edhe fuqia e kulturës

sonë. Për të ruajtur këtë pasuri, do të krijojmë zgjidhje të cilat proporcionalisht do të përkrahin dhe avancojnë gjuhët e tjera, kulturat dhe institucionet për këtë qëllim, do të japim përkrahje edhe për projektet interkulturore si dhe praktikën shumë gjuhësore.

Do të fusim një praktikë të rregullt të përkrahjes politike esenciale dhe simbolike për ndërtimin e një shoqërie të bashkuar. Përfaqësuesit e lartë qeveritar, në përbërje të përzier, së bashku do të jenë të pranishëm në të gjitha mjediset e përziera etnike dhe do të vizitojnë shkollat e përziera etnike, ku në mënyrë publike dhe aktive do të flasin për rëndësinë e ndërtimit dhe ruajtjes së një shoqërie të bashkuar, tolerante dhe multietnike në Maqedoni. Nëse vetë politikanët e ruajnë këtë vlerë, atëherë toleranca si një element i rëndësishëm i shoqërisë multikulturore, do të forcohet si një faktor i rëndësishëm në mjediset multietnike.

Qeveria do të udhëheq politikë të afirmimit dhe avancimit të kulturës së pjesëtarëve të bashkësive. Do të forcohen kapacitetet e drejtorisë për afirmimin dhe avancimin e kulturës së pjesëtarëve të bashkësive (njerëzore, infrastrukturore, financiare, politike) që të mund ta realizojë funksionin e vetë me fuqi të plotë si dhe të jetë një faktor relevant në sistemin kulturor të vendit. Përkrahje do të fitojnë edhe institucionet e kulturës së pjesëtarëve të komuniteteve.

Fuqishëm do të stimulojmë organizimin e emisioneve të rregullta debatuese në programet e shërbimit publik të radiodifuzionit, RTVM. Do të nxisim edhe përmbajtje tjera programore në të cilat do të përfshihen edhe përfaqësuesit e të gjitha bashkësive që jetojnë në këtë shtet. Në këtë mënyrë edhe më tepër do ta përkrahim dialogun publik për të gjitha temat dhe problemet e nxehta e të cilat bëjnë presion te njerëzit. Do të insistojmë që në këtë aktivitet me potencialet e saja kreative dhe politike, në tërësi të kësaj edhe sektori civil si dhe organizatat joqeveritare të Maqedonisë.

Qeveria fuqishëm do të mbetet në qëndrimin se vetëm një Maqedoni e integruar e cila do t'i bashkojë të gjitha dallimet, do të jetë një shtet stabil dhe me prosperitet për të gjithë qytetarët e saj.

## **Pushtet i përgjegjshëm dhe kontrolli i pushtetit**

Pakoja e reformave të domosdoshme për anëtarësim në BE dhe NATO, mund të realizohet vetëm në kushte të një pushteti të përgjegjshëm i cili punon në mënyrë transparente dhe me llogaridhënie, pa keqpërdorim të resurseve shtetërore për interesat personale ose partiake. Për këtë qëllim në gjashtë muajt e parë, Qeveria e Republikës së Maqedonisë do të miratojnë një Strategji për menaxhim të mirë me të cilën do të garantohet një transparencë e rritur e të gjithë institucioneve shtetërore, konsultimeve të obligueshme me qytetarët, bashkësinë e biznesit dhe organizatat civile, si dhe një kontroll të forcuar të rolit të Kuvendit.

Vëmendje e veçantë do t'i kushtojmë transparencës së plotë të shpenzimit të parave të qytetarëve. Me përkushtim do të punohet që Maqedonia të kalojë në grupin më të lartë të vendeve të indeks-listës për Buxhet të hapur dhe ta rrisë notën prej në 35 në 65, me cka do të renditet në listën e vendeve me një transparencë të konsiderueshme të buxhetit.

Me qëllim të rritjes së transparencës, Qeveria e Republikës së Maqedonisë në tërësi do ta implementojë konceptin e një qeverie të hapur, në pajtim me Partneritetin për qeveri të hapur (Open Government Partnership). Në këtë drejtim Qeveria:

- do të propozojë ndryshime ligjore për përgjysmimin e afatit ligjor për përgjigje ndaj kërkesave për qasje deri te informatat me karakter publik prej në 30 në 15 ditë;
- do të fusë parimin e a.q. “transparencë aktive” të institucioneve që nwnukton publikimin (pa u kwrkuar) të programeve të tyre (edhe propozim-programeve), strategjive, mendimeve dhe studimeve, të dhënave për organizimin dhe shpenzimet e punës, si dhe vendimet, aktet dhe masat me të cilat do të ndikojnë në jetën dhe punën e qytetarëve dhe kompanive.
- do të krijojë një proces të konsultimeve të garantuara me sektorin civil me odat, me sindikatat dhe me faktorët tjerë relevant në sferat e punës së pushtetit, gjatë miratimit të ligjeve ose ndryshimit të atyre ekzistues.
- Çdo vit për 10% do të rritet numri i institucioneve të cilat do të përcjellin rekomandimet për Qasje në të dhënat e hapura (Open Data Approach).
- Do të realizohet regjistrimi i popullsisë sipas kriterëve dhe standardeve ndërkombëtare. Të dhënat do të mundësojnë institucioneve shtetërore, komunitetit akademik dhe atij të biznesit, sektorit civil; një analizë të vërtetë dhe krijimin e politikave reale në çdo sferë.
- Do të propozohet në Kuvend, formimi i “Këshillit fiskal”, si një organ i pavarur, në të cilin do të marrin pjesë ekspertë të dalluar të financave dhe ekonomisë, me mision që të vlerësojnë kredibilitetin e politikës fiskale si dhe të sigurohet transparenca dhe parashikimi i saj.
- Çdo vit do të ripërtërihet strategjia fiskale trevjeçare (sipas parimit - rollover) dhe ajo do të publikohet në fillim të vitit, pasi që do të konstatohen prioritetet e Qeverisë për vitin e ardhshëm fiskal. Kjo strategji do të diskutohet dhe do të votohet në Kuvendin e RM-së, me qëllim që të inkurajohet debat për agregatet fiskal dhe buxhetor, me qëllim që të paraqesë një bazë për pritshmërinë nga ana e agjentëve ekonomik.

- borxhi publik do të publikohet në tërësi dhe rregullisht, pa përjashtime dhe politika të kalkulimeve. Në kuvend do të propozojmë edhe ndryshimin e Kodit penal me qëllim të fshehja e borxhit publik të paraqesë vepër penale.
- do të sigurohet publikimi i të dhënave si për borxhin e garantuar ashtu edhe për atë jo të garantuar, të ndërmarrjeve publike dhe komunave.
- do të propozohet futja e një obligimi për shfrytëzuesit buxhetor, fondet dhe ndërmarrjet publike, për të dorëzuar deri te Ministria e financave, raporte të detajuara mujore për pagesën e parave të dhëna nga Buxheti, së bashku me obligimet që i kanë marrë e që nuk i kanë paguar. Këto të dhëna, me ndihmën e platformës për kërkim, do të shpallen në ueb faqen e Ministrisë së Financave. Me këtë qytetarët do të jenë kontrolluesit e vërtet të keqpërdorimeve të mundshme, sepse secili qytetar, nga kompjuteri i tij personal mund të shoh në detaje ku shpenzohen paratë nga tatimet dhe kontributet e tija.
- do të propozojë ndryshime ligjore me qëllim të futjes së obligimit që llogaritë përmbyllëse e të gjithë shfrytëzuesve buxhetor dhe ndërmarrjet publike të publikohen në internet.
- do të propozojë ndryshime ligjore për të gjitha of-shor kompanitë që investojnë në Maqedoni dhe të obligohen për të shpallur pronarët e vërtetë dhe të dorëzojnë historinë e plotë të këtyre kompanive.
- shpallja e listave të detajuara mujore për të gjithë të punësuarit në administratën publike dhe shfrytëzuesit e subvencioneve bujqësore, me qëllim që qytetarët të jenë kontrolluese, nëse bëhen keqpërdorime.



## Qasja në drejtësi

Qeveria e Republikës së Maqedonisë do të punojë në krijimin e kushteve për gjyqësor të pavarur, departizuar dhe efikas me qëllim drejtësia të jetë e arritshme për të gjithë. Për atë qëllim, për ligjet për të cilat është e nevojshme shumicë absolute në Kuvend do të propozohen ndryshime ligjore, kurse për sferat për të cilat janë të nevojshme shumica e 2/3, do të fillojë dialog në Kuvend me qëllim të arritjes konsensusit më të gjerë për reforma.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë do t'i mundësojë të gjitha kushtet institucionale, materiale dhe gjithëpërfshirëse për punë të Prokurorisë Speciale Publike para secilës qëndron përgjegjësi e madhe për zbardhjen e skandalit me përgjimet dhe luftën kundër korrupsionit, krimit dhe keqpërdorimit të pushtetit. Qeveria urgjentisht do të propozojë vazhdimin e afatit në të cilën PSP mund të ngrit akuza si dhe mbrojtjen e dëshmitarëve në rastet të cilat janë në kompetencë të tij me çka do të mundësohen hetime kualitative, përgjegjësi për të gjitha keqpërdorimet dhe funksionim efikas shtetit ligjor.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë deri te Kuvendi do të propozojnë ndryshime ligjore:

- Për rritjen e transparencës në punën e Këshillit Gjyqësor, për shkak të profesionalizimit të saj më të madh, pavarësi dhe ndërgjegje në punë,
- Reforma në Akademinë për Gjykatës dhe Prokurorë Publik
- Për abrogimin e ligjit për caktimin e llojit dhe matjen e lartësisë së dënimit, si ligj i cili përmban zgjidhje paradoksale dhe të paqëndrueshme.
- Për uljen e taksave gjyqësore, sepse qytetarët në Republikën e Maqedonisë shpesh herë heq dorë nga mbrojtja gjyqësore për të drejtat e tyre për shkak të taksave të larta gjyqësore. Në procedurat gjyqësore të cilat paditet shteti për shkeljen e të drejtave të qytetarëve taksat gjyqësore do të paguhen vetëm pas mbarimit të procesit, nëse gjykata konstaton se nuk ka pasur shkelje të tyre.
- Në ligjin për shërbim gjyqësor për shkak të përmirësimit të statusit të nëpunësve gjyqësor.
- Në ligjin për noter dhe ligjin për përmbarues me qëllim që të ulen shpenzimet e qytetarëve në procedurat para përmbaruesve dhe noterëve.

Qëllimi i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë është drejtësia të jetë e arritshme për të gjithë, me çka do të mundësojë ndihmë juridike pa pagesë të vërtetë për kategoritë të qytetarëve të prekur, me rritjen e kapacitetit të Ministrisë së Drejtësisë dhe integrimin e shoqatave të cilat sigurojnë ndihmë juridike në sistem të vetëm.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë do të hapë edhe dialog të gjerë në Kuvend për shkak të sigurimit të përkrahjes më të gjerë dhe shumicë:

- Për vendosjen e dhomës së specializuar në gjykata për veprim për lëndët të cilat janë kompetencë e Prokurorisë Speciale Publike.
- Për reforma kushtetuese të Këshillit Gjyqësor, si dhe për ndryshime të ligjit për gjykata për shkak të vendosjes së kriterëve të qarta për zgjedhje, avancim dhe

shkarkim të gjykatësve. Konsiderojmë se kualiteti dhe efikasiteti i gjykatësve do të vlerësohen objektivisht, sipas numrit të lëndëve të zgjidhura, numri i ankesave të ankimuara, numri i aktgjykimeve të vërtetuara, arsyet për pezullimin e aktgjykimit dhe kohëzgjatjen e procedurave gjyqësore. Edhe krahas kësaj, kritere për vlerësimin e kualitetit të gjykatësve do të jenë të drejtuar drejt vlerësimit të aftësive kyçe për profesion, si për shembull logjika juridike, aftësitë organizative, pjesëmarrja në trajnime, specializimit, arsyetimi i aktgjykimit dhe ngjashëm.

- Për vendosjen e gjykatave të specializuara tregtare për përmirësimin e biznes ambientit dhe garantimin e sigurisë juridike për ato që hapin vend pune.
- Për reforma themelore në Prokurorinë Publike.
- Për rritjen e transparencës dhe gjykatave administrative përmes vendimmarrjes të detyrueshme në seancën publik kryesor, si dhe vendosjen e obligimeve për vendimmarrje meritorë nga ana e Gjykatës së Lartë Administrative çdo herë kur për akt të hedhur poshtë nga akt i njëjtë administrativ është parashtruar padi për herë të dytë.

## Të drejtat e njeriut

Qeveria e Republikës së Maqedonisë do t'i promovojë, mbrojë dhe avancojë të drejtat e njeriut në Republikën e Maqedonisë dhe do të krijojë kapacitete institucionale për mbrojtje të tyre efikase dhe përgjegjësi të të njëjtave të cilat do të tentojë që t'i shkelin të drejtat e njeriut. Theks i veçantë do të vihet në kthimin e besimit në pushtetin si ruajtës i të drejtave të njeriut dhe mbrojtjen e atyre të drejta të cilat ishin shkelur në mënyrë flagrante. Qëllim me prioritet i Qeverisë është ta kthejë lirinë në Republikën e Maqedonisë dhe të ndërtojë shtet në të cilën qytetarët do të ndihen të lirë, të barabartë, të sigurt dhe me dinjitet!

Për shkak të implementimit të standardeve evropiane për të drejtat e njeriut dhe mbrojtje efikase të të drejtave të njeriut, Qeveria e Republikës së Maqedonisë do të:

- Propozojë ndryshime ligjore me qëllim personave të cilëve i është shkelur ndonjë e drejtë e njeriut të marrin kompensim real dhe si deri tani kompensim simbolik për shkelje. Ajo do të jetë edhe bazë për përgjegjësi personale të gjykatësve dhe prokurorëve të cilët kanë marrë pjesë në shkeljen e të drejtës.
- Hap debat për ndryshime kushtetuese dhe do të kërkojë përkrahje për kufizime kushtetuese për kohëzgjatjen e paraburgimit, si dhe për forcimin e bazave ligjore dhe mekanizmat e kontrollit të bazës të privimit nga liria dhe shfrytëzimin e masës së paraburgimit.
- Propozon kornizë ligjore në të cilën do të përmbahen standardet evropiane për mbrojtjen e presumimit të pafajësisë dhe dënime në pajtim me standardet evropiane në rast të shkeljes së kësaj të drejte.
- Propozon ndryshime ligjore për reforma në Komisionin për Mbrojtje nga Diskriminimi, e cila do të shndërrohet në trup të pavarur, profesional me kompetenca më të mëdha, krijuar nga persona të cilët i janë kushtuar mbrojtjes së të drejtave të njeriut.
- Kërkon përkrahje më të gjerë për ndryshim të ligjit për ndjekjen e komunikimeve, me qëllim propozimi për ndjekjen e komunikimeve të mos mund t'i jepet cilit do nëpunës policor, dhe ta ulë periudhën në të cilën mund të zgjatë kufizimi i fshehtësisë së komunikimeve. Kufizimi i fshehtësisë të komunikimeve duhet të jetë i kontrolluar rreptësisht dhe vetëm kur është e domosdoshme për mbledhjen e të dhënave për shkak të realizimit të qëllimeve të ndjekjes.
- Propozoi ndryshime të Ligjit të policisë, me qëllim më saktë të përcaktohen metodat të kontrollit operativ, periudha maksimale e mbikëqyrjes së personave dhe të vendosjen edhe garanci tjera, me të cilat do të kufizohet sjellja e vullnetshme e policisë.
- Propozoi ndryshime të Ligjit për përgjegjësi qytetare për ofendim dhe shpifje dhe do ta ulë lartësinë e kompensimit të dëmit për shkelje të shqiptuar ose shpifje në Republikën e Maqedonisë.
- I përmirëson kushtet në institucionet korrigjuese-ndëshkuese me qëllim implementimin e ndalesës për torturë, dhe dënimin jonjerëzor ,ofendues dhe veprime. Do të vendosim kontroll të tërësishëm mbi realizimin e autorizimeve policore në këto institucione me qëllim të largohen paraqitja e trajtimit joadekuat

dhe forcë e tepruar nga ana e policisë në këto institucione. Do të vendosim edhe trajnim sistematik të nëpunësve të burgjeve, si dhe procedura për shqyrtim detal të të gjitha ankesave për shkelje eventuale të të drejtës të trajtimit të dinjitetshëm. Në atë drejtim do të forcohet roli i Avokatit të Popullit si mekanizëm preventiv për mbrojtje nga tortura, dënimin jonjerëzor dhe ofendues si dhe veprime. Në mënyrë plotësuese do t'i përmirësojmë kushtet në institucionet korigjuese ndëshkuese, në veçanti lidhur për mbrojtjen shëndetësore dhe trajtim me dinjitet.

- Propozoi ndryshime të Ligjit për referendum dhe forma tjera të shprehjes së drejtpërdrejt të qytetarëve. Ndryshimet do të parashohin afate precize për të gjitha veprimet e organeve shtetërore të cilat kanë kompetencë në realizimin e kësaj të drejte të qytetarëve, si dhe saktësimin e dispozitave të caktuara të cilat shkaktajnë probleme në praktikën dhe u keqpërdorën nga ana e pushtetit që t'i pamundësojë ose dekurajojë qytetarët në shfrytëzimin e mekanizmave për demokraci të drejtpërdrejtë.
- Propozoi ndryshime ligjore për garantimin e të drejtës së mbledhjes publike, me kompetenca të sakta dhe precizë të policisë.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë do të udhëheqë politikë në avancimin e të drejtave të grave dhe rritjen e pjesëmarrjes së tyre në jetën politike, ekonomike dhe publike. Për atë qëllim do të vendosim trup të veçantë qeveritar për barazi gjinore e cila do të kujdeset për implementimin e perspektivës gjinore në krijimin e politikave dhe buxheteve.

Qeveria do të insistojë në reforma arsimore, mediatike dhe kulturore të cilat do shpin drejt tejkalimit të stereotipeve për rolin e femrës dhe do të stimulojnë shanse më të mëdha për femrat dhe gratë në shtetin tonë.

Qeveria do të propozojë ratifikim të Konventës së Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftë kundër dhunës mbi gratë dhe dhunës familjare nga viti 2011 (Konventa e Stambollit) dhe në pajtim me të njëjtën, do të vendoset rrjet i standardizuar i institucioneve të cilat e garantojnë pakon minimale të shërbimeve për mbrojtje nga dhuna familjare. Gjithashtu, do të propozohet ligji i ri për dhunën e bazuar gjinore dhe ndryshime në Kodin Penal me vendosjen e dispozitave për të gjitha format e dhunës në bazë gjinore.

Qeveria do të vendosë programe për ndihmë të zhvillimit të grave-sipërmarrëse, në veçanti ato në rajonet rurale.

## **Policia profesionale - siguri për të gjithë qytetarët**

Qeveria e Republikës së Maqedonisë do ta ndërtojë policinë e cila do t'i mbrojë qytetarët dhe e cila do ta ndjek krimin. Vetëm policia e tillë mund të garantojë siguri dhe shtet juridik. Policia do të jetë jashtë ndikimeve partiake dhe do të garantojë zbatim objektiv të ligjeve për të gjithë. Do të fusim mekanizma për përmirësimin e kontrollit të jashtëm dhe të brendshëm në punën e policisë dhe shërbimeve të sigurisë. Do ta përforcojmë kontrollin parlamentar dhe do të formojmë ombudsman policor, me kompetencë të zbatohet hetim të pavarur për tejkalimet eventuale të autorizimeve policore dhe shkeljen e lirive dhe të drejtave të njeriut. Rekomandimet nga „Raporti i Pribesë“ do t'i zbatohet plotësisht dhe pa prolongime.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë do të punojë me përkushtim në departizimin e policisë dhe luftën kundër korrupsionit, zbatimin objektiv dhe jodiskriminues të ligjeve; luftën efikase kundër korrupsionit dhe raport dhe transparencë në punën e policisë.

Për këtë qëllim, Qeveria e Republikës së Maqedonisë do ta ripërtërijë konceptin e policit - polici i uniformuar lokal në rrugët e vendbanimeve. Ai do të jetë mbrojtës - i arritshëm për qytetarët dhe nevojat e tyre. Përforcimi i besimit ndërmjet policisë dhe qytetarëve është parakusht për sigurinë e qytetarëve.

Në funksion të kthehet sistemi i karrierës për të punësuarit në MPB me respektimin e rregullave për avancimin dhe sistematizimin e të punësuarve, duke mbajtur kujdes për shfrytëzimin e kapacitetit profesional të të punësuarve në MPB.

Qeveria do të mbështesë mekanizma për mbikëqyrje mbi veprimin policor në rastet e përfshirjes së drejtpërdrejtë apo të tërthortë të policisë në veprimet e padëshiruara të shoqërisë. Barazia para ligjit duhet të jetë garanci për sigurinë e qytetarëve. Në punën e policit do të shikohet si mbrojtje, e jo si kërcënim. Për këtë shkak, do të përforcohet pavarësia dhe kapaciteti i Sektorit të Kontrollit të Brendshëm dhe Standardet Profesionale në MPB dhe do të futet një mënyrë e re në zgjedhjen e ndihmësit të ministrit për kontroll të brendshëm dhe standarde profesionale, në bazë të kriterëve të cilat do të garantojnë pavarësi në veprimin dhe hetimet profesionale.

Qeveria do të përkushtohet në zbardhjen e plotë të ngjarjeve të Kumanovës në maj të vitit 2015 dhe zbulimin e iniciatorëve dhe prapavijën e tërë ngjarjes. Do të kërkojmë edhe mbështetjen ndërkombëtare në hetim për shkak të sigurimit të të gjitha informatave relevante, por edhe të sigurimit të besimit të plotë të qytetarëve në rezultatet e hetimit. Njëherit, ministria resore do të jap mbështetje të plotë logjistike në instancat e prokurorisë dhe të gjyqësisë në hapjen dhe mbajtjen e procedurave në lëndët „Sopot“, „Brodec“, vdekjen e Martin Neshkovskit dhe Nikolla Mlladenovit dhe lëndën „Monstra“.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë do të bëjë evalvimin për zbatimin e Marrëveshjes Kolektive për të punësuarit në MPB dhe respektimin e legjislacionit të punës. Nëse përcaktohen lëshimet, dobësitë dhe parregullsitë do ta hapim dialogun social për përmirësimin e Marrëveshjes Kolektive për shkak të mbrojtjes së të drejtave të nëpunësve policorë. Do të lejojmë organizimin e lirë sindikal të nëpunësve policorë dhe lirinë e vendimmarrjes për anëtarësim në sindikatë. Standardi dhe cilësia e jetës së pjesëtarëve të MPB-së do të përmirësohen edhe me sistematizimin e tyre në punë në vendbanim. Në këtë mënyrë, do t'u zvogëlohen shpenzimet për jetë të ndarë dhe udhëtime të cilat deri më tani ishin në barrë të tyre. Në raste të jashtëzakonshme, në të cilat do të ketë nevojë për punë jashtë vendbanimit, ministria do të sigurojë kompensim për jetë të ndarë dhe shpenzime të rrugës. Qeveria do t'i qaset harmonizimit të bazës

së rrogave të të punësuarve në MPB dhe përcaktimin e kompensimeve dhe shtesave të rrogës, në pajtim me Marrëveshjen Kolektive të MPB-së dhe Ligjit për marrëdhënie pune.

Njëri ndër aktivitetet kryesore të reformës do të jetë në Drejtorinë për Siguri dhe Kundërzbulim. Rekomandimet e Pribesë dhe shfrytëzimi i përvojave evropiane do të jenë orientuesit kryesorë në këtë proces. Qeveria plotësisht do ta mbështesë kontrollin e Kuvendit mbi këtë Drejtori.

Qeveria do t'i përforcojë kapacitetet institucionale dhe kadrovike në Seksionin e Krimin të Organizuar në MPB dhe institucioneve me të cilat bashkëpunon. Do të formohet dhe operacionalizohet Qendra Koordinuese Nacionale për Luftën kundër Krimin të Organizuar. Do të angazhohemi për zbatim të plotë të legjislacionit për dëmshpërblimin e viktimave nga krimi i organizuar.

Qeveria plotësisht do t'i zbatojë obligimet e saj në aspekt të zbatimit të plotë të Ligjit për procedurë penale në pjesën e resurseve, organizimit, pajisjes dhe trajnimit të agjentëve dhe prokurorëve, si dhe formimin e qendrave të hetimit dhe policisë gjyqësore. Zbatimi i plotë dhe përkatës i LPP-së është garanci për hetim profesional dhe të pavarur, në të cilën do të mënjanohej dyshimet për anshmëri të policisë në rastet e montuara politike.

Do të investohet në kapacitetet e institucioneve për parandalimin e migrimit joligjor dhe tregtisë me njerëz, dhe do të sigurojmë qëndrueshmëri dhe funksionalitet të Qendrës për Mbrojtjen e viktimave nga tregtia me qenie njerëzore.

Qeveria do të sigurojë mjete për renovimin e stacioneve policore, veçanërisht atyre për sigurimin e kufirit shtetëror. Do të investohet në funksionimin efikas të Sistemit për menaxhim të integruar kufitar, në bashkëpunim me shtetet fqinje dhe institucionet evropiane dhe mbështetjen nga vendet-anëtare të BE-së dhe NATO-s.

## Mediune të lira

Qëllimi i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë është krijimi i hapësirës së mediave për informim objektiv të qytetarëve, sepse vetëm qytetarët e informuar në mënyrë të vërtetë mund lirisht të miratojnë vendim për të ardhmen e shtetit të tyre.

Qeveria do të promovojë reforma në sferën mediatike në pajtim me masat e grupit të organizatave joqeveritare të prononcuara në konferencën “Propozimet për reformat demokratike urgjente”. Procedurat për ndryshime do t’i zbatohet në mënyrë transparente dhe me përfshirjen e të gjithë faktorëve relevantë nga kjo sferë. Qëllimi ynë është që medieve të shtypit dhe medieve elektronike t’u sigurojmë lirinë e informimit të qytetarëve, për artikullimin e nevojave të tyre dhe për zhvillimin e biznesit të medias. Radiodifuzerët do të kenë trajtim të barabartë në drejtim të zhvillimit të konkurrencës së shëndoshë ndërmjet shtëpive mediatike.

Në këtë reformë, kryesore janë trupat rregullatorë. Do të propozojmë model sipas modeleve të ngjashme në vendet-anëtare të BE-së, veçanërisht modeli britanik OFCOM. Në krye të këtyre trupave, në bashkëpunim me sektorin civil, do të vendosim profesionistë me përvojë, objektivë dhe të dëshmuar.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë do të propozojë ndërprerjen e taksës radiodifuzive. Financimi i RTM-së më nuk do të bëhet përmes taksës radiodifuzive, si taksë e detyrueshme e qytetarëve. RTM-ja do të financohet i kombinuar nga Buxheti i RM-së dhe me mjete tjera, nga të ardhurat e operatorëve kabllovikë dhe nga të ardhurat e realizuara me shitjen e programit të prodhuar në RTM. Në mënyrë plotësuese, do të propozojmë zgjidhje ligjore me të cilat RTM-në nga buletinet partiake do ta transformojmë në servis profesional për të gjithë qytetarët dhe në shtyllë të fortë identiteti të Republikës së Maqedonisë.

Qeveria do të pushojë me shpenzimin e mjeteve buxhetore në medie. Publikimet falas do të dedikohen kryesisht për projektet me interes publik. Do të propozohet ndalimi për reklamimin e partive politike, përveç gjatë kohës së fushatës zgjedhore.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë do ta rishqyrtojë rregullativën që ka të bëjë me përqendrimin mediatik dhe pronësinë mediatike, në drejtim të sigurimit të standardeve të larta për mbështetjen e sistemit demokratik në shtet dhe do t’i zvogëlojë kompensimet për lejet për punën e radiodifuzerëve.



## Institucionet në shërbim të qytetarëve

### Arsimi për kohën e re

Qeveria e Republikës së Maqedonisë do të zhvillojë sistem të integruar i cili do të ndikojë në rritjen ekonomike dhe produktivitetin e punës dhe do t'i rrit mundësitë e të rinjve për vende pune cilësore. Qëllimi ynë është ky të sigurojë integrim të madh shoqëror në kuptimin etnik, rajonal, social dhe kulturor të nxit mendimin kritik dhe qytetarinë aktive.

Rezultatet e fundit nga testimi i PISA-s për nxënësit në Republikën e Maqedonisë tregojnë se na nevojiten reforma urgjente dhe gjithëpërfshirëse në arsim. Kësaj reforme do t'i paraprijë një debat i gjerë publik në të cilin do të marrin pjesë të gjitha subjektet në arsim, organizatat civile dhe shoqatat profesionale. Koncepti që do të dalë prej këtij debati gjithëpërfshirës do të fillojë me zbatim në vitin 2018. Duke i shfrytëzuar përvojat e huaja produktive dhe praktikat e mira, do të ndërtojmë një koncept personal të arsimit, që është përkatës në nevojat dhe mundësitë tona, duke i respektuar standardet evropiane. Do t'i japim mbështetje të plotë kuadrit mësimor dhe do ta mbrojmë nderin, dinjitetin dhe autonominë e profesionit mësimdhënës. Mësimdhënësit në Maqedoni e meritojnë këtë mbështetje, sepse pa mësimdhënës të motivuar nuk ka ndryshime të suksesshme arsimore.

Qeveria do të mbajë politikë për lehtësimin e përmbajtjeve mësimore dhe zvogëlimin e ngarkimit të nxënësve në arsimin fillor dhe në arsimin e mesëm. Do të vëmë fokusin në shkathtësitë dhe lëndët matematikore dhe gjuhësore, që janë të rëndësishme për zhvillimin e kompetencave kryesore të fëmijët. Investimet kapitale në arsim, si dhe angazhimi i kuadrit mësimor do të diktohen nga nevoja për arsimin e arritshëm dhe cilësor për të gjithë fëmijët. Këto investime duhet të ndihmojnë në realizimin e qëllimit për numrin mesatar të nxënësve që çdo paralele të ketë 25 nxënës.

Qeveria do ta respektojë autonominë e universitetit dhe dinjitetin e profesorëve, me ç'rast universitetet shtetërore do të jenë plotësisht përgjegjëse për funksionimin e arsimit të lartë sipas dispozitave kushtetuese dhe ligjore. Qeveria do të propozojë një mënyrë të re të menaxhimit me universitetin, që do të shpie në një universitet efikas dhe transparent.

Rritjen ekonomike do ta përshpejtojmë edhe me investime në shkencë. Qeveria do të formojë fond shtetëror për hulumtim dhe zhvillim me të cilin financimi i deritanshëm buxhetor që është minimal (0,2% të BPV-së – pesëmbëdhjetë herë më pak se rekomandimet e strategjisë Evropa 2020) do ta rrisim për 50% në buxhetin e parë, me qëllim në fund të mandatit Maqedonia të ndajë ndërmjet 1% dhe 1,5% të BPV-së për hulumtim dhe zhvillim.

Qeveria do të propozojë ndërprerjen e testimit ekstern si projekt që shkakton revolt të madh të mësimdhënësit, por krijon shqetësim dhe pakënaqësi edhe të nxënësit dhe prindërit e tyre. Testimi ekstern e zhvlerëson tërë angazhimin dhe punën e mësimdhënësve dhe të nxënësve gjatë tërë vitit shkollor, dhe se nuk shpie në rritjen e cilësisë. Do të fusim evalvimin dhe testimet e nxënësve, por pa futjen plotësuese të notave në dëftesat e tyre dhe pa dënime për mësimdhënësit. Vlerësimi i njohurisë së nxënë do të zbatohet vazhdimisht. Atyre shkollave që do të tregojnë rezultate të dobëta, do t'u jepet ndihmë dhe mbështetje për avancimin e arsimit.

Përfshirja e tanishme e fëmijëve të moshës 0-6 vjeç në arsimin parashkollor, në

mesatare, është vetëm 23%, te bashkësitë e vogla etnike kjo përfshirje është nën 10%. Kjo është e pamjaftueshme dhe ka ndikim negativ mbi zhvillimin e ardhshëm të Republikës së Maqedonisë. Qeveria do ta bashkëfinancojë çdo rritje të kapacitetit në kopshtet për fëmijë në tërë shtetin. Qëllimi ynë është mesatarja e fëmijëve të përfshirë me arsimin parashkollor të rritet për 50% në periudhën prej 4 vitesh. Qeveria do të përgatit Plan të saktë për zgjerimin e rrjetit të kopshteve për fëmijë nëpër Maqedoni. Me investimin do të përfshijmë rekonstrukcionin dhe ndërtimin e kopshteve të reja për fëmijë, në një numër të madh të komunave rurale dhe urbane, në mesin e të cilave, në Strugë, Gjorçe Petrov, Sopishtë, Qendër, Aerodrom, Tearcë, Gostivar, Llozovë, Karbinci, Çair, Shuto Orizar, etj.

Qeveria do të zbatojë arsimin e detyrueshëm parashkollor njëvjeçar, si masë integruese dhe përgatitje të fëmijëve për hyrje në arsimin fillor 9-vjeçar. Kjo do të kontribuojë për barazimin e fëmijëve nga mjedise të ndryshme sociale, si dhe për fillimin me elementet e procesit edukativ, i cili në vitet e kaluara u zhduk nga sistemi arsimor. Fëmijët duhet të kenë qasje të barabartë në arsim, sepse ky është çelësi për suksesin e tyre të mëtejshëm në jetë. Kjo përfshirje plotësisht do të jetë falas për fëmijët në komunat të cilat janë të nënshkruara në zvogëlimin e popullsisë dhe të cilat kanë zhvillim të pavolitshëm ekonomik.

Sistemi i arsimit fillor në 5 vitet e para do të jetë vetëm me vlerësim të përshkruar. Madje pastaj (4 vitet e ardhshme të arsimit fillor) do të zbatohet vlerësimi numerik. Në këtë mënyrë, fëmijët dhe mësimitdhënësit do t'i përkushtohen cilësisë së njohurisë, e jo garës për nota.

Qeveria do të ofrojë arsim të mesëm i cili zgjat dy, tri apo katër vjet: do ta mbajmë arsimin klasik të gjimnazit dhe arsimin profesional katërvjeçar, por do të fusim edhe mundësinë për të mbaruar vitin e dytë dhe të tretë tek arsimit profesional. Ndryshimi do të jetë në atë që në tregun e punës kuadrot e para do të përfshihen nga dy apo tri vjet arsim të mesëm profesional, në moshën 17-vjeçare. Pra, ata të cilët duan të përfshihen në tregun e punës nuk duhet pa nevojë t'i mbajmë në sistemin arsimor, shpesh me rezultate më të dobëta të realizuara në nivelet më të larta të arsimit. Këtyre të rinjve do t'u mundësojmë hyrje të shpejtë në ekonomi dhe kohë ta përgatisë dhe planifikojë karrierën e tij të punës, me mundësitë për shkollim të mëvonshëm plotësues.

Në vend të politikës së ndëshkimeve, Qeveria do të promovojë politikën e shpërblyemeve dhe stimulimeve. Të punësuarit në 5% të shkollave më të mira fillore dhe 10% të shkollave më të mira të mesme, si dhe mësimitdhënësit, nxënësit e të cilëve do të fitojnë çmime në garat e qytetit dhe ato shtetërore, do të marrin 20% rrogë më të madhe gjatë 12 muajve të ardhshëm. Shkollat që do të jenë në 10% e sipërm sipas rezultateve që i arrijnë në cilësinë e tyre arsimore, do të kenë të drejtën që në dëftesa t'i theksojnë pikat plotësuese, si shkolla me rezultate mbimesatare.

Krahas lëndëve të detyrueshme, në shkolla do të fusim aktivitete të lira për kreativitet më të madh. Do t'i lirojmë mësimitdhënësit nga obligimet administrative, por do të kërkojmë prej tyre të punojnë me të rinjtë në zhvillimin e talentëve të tyre.

Qeveria do të stimulojë përforsimin e ekipeve shkollore me persona profesionalë nga profile të ndryshme: pedagogë, psikologë, defektologë, sociologë, logopedë, punëtorë socialë dhe persona profesionalë mjekësorë (aty ku ka mundësi për të).

Byroja për Zhvillimin e Arsimit do të ristrukturohet dhe do të shndërrohet në Institut për Zhvillimin e Arsimit. Ky do të jetë „tink-tenk“ i arsimit shtetëror në kornizat e të cilit

do të punojnë më tepër sektorë që vazhdimisht do të dizajnojnë hulumtime në sferën e arsimit, me qëllim të përmirësimit të cilësisë së procesit arsimor.

Qeveria do të formojë Qendër të Hulumtimit Shkencor për nxënësit e talentuar në të cilin ata do të mund të nxënë njohuri plotësuese, do të përgatiten për garat shtetërore dhe ndërkombëtare dhe do të fillojnë me punë më serioze hulumtuese.

Në afat prej viti, komisionet shtetërore të përbëra nga profesorët universitarë dhe të mbështetura nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, do të bëjnë evalvimin e të gjithë librave shkollorë për arsimin fillor dhe të mesëm dhe do të vendosin rregulla të qarta të cilat duhet të respektohen. Do të tërhiqen nga përdorimi librat shkollorë që kanë gabime esenciale në materie dhe të cilat janë joadekuate për moshën e nxënësve. Njëkohësisht, do të zbatojmë lirinë e lëndëve mësimore nga përmbajtjet e panevojshme dhe të dëmshme, veçanërisht të atyre që nxisin agresivitet, jotolerancë, urrejtje dhe diskriminim.

Pjesa më e madhe e librave dhe mjeteve tjera ndihmëse do të jenë të arritshme në formë elektronike. Për këtë masë, Qeveria do të stimulojë: autorë vendorë, prodhim audio dhe video, produksion të emisioneve arsimore dhe të popullarizuara shkencore si materiale shkollore me përmbajtje dhe tema nga programi mësimor. Do t'i nxisim televizionet nacionale të veçojnë kohë të caktuar për emetimin e këtyre programeve, të cilat do të harmonizohen me lëndët mësimore. Me të do të krijohen mundësitë e njëjta për arsimin cilësor në të gjitha pjesët e shtetit.

Qeveria do të iniciojë reforma dhe ristrukturim në arsimin e mesëm profesional në bashkëpunim me sektorin privat. Në këtë mënyrë edhe kompanitë mund të marrin pjesë, me programe dhe me financa, në këtë shkallë dhe lloj të arsimit. Në këtë mënyrë, shkollat profesionale për disa vjet do të bëhen më atraktive për nxënësit, veçanërisht me mundësinë për punësime të drejtpërdrejta pas mbarimit të kësaj shkalle dhe lloji të arsimit. Njëherit, do të promovojmë mekanizma dhe instrumente me të cilat do t'i nxisim punëdhënësit të bashkëpunojnë, të investojnë dhe të marrin pjesë në aktivitetet e arsimit dhe trajnimit. Në këtë drejtim është edhe masa për lirim nga tatimi mbi fitim deri në 30% për investim në zhvillimin e arsimit.

Në tërë shtetin, në përgjithësi, evidente është mosharmonizimi i ofertës së kuadrove të punës me kërkesat në tregun e punës. Me hartimin e Kornizës Nacionale të Kualifikimeve, do të mundësojmë lidhjen e programeve studimore që i ofrojnë institucionet e arsimit të lartë me ekonominë dhe me tregun e punës.

Në periudhën e kaluar universiteti me vetëdije ishte vënë në margjinat e shoqërisë, kurse profesorët ishin heshtur. Me rregullimin plotësues të arsimit të lartë, Qeveria do ta sigurojë autonominë universitare të garantuar me Kushtetutë, lirinë akademike, dinjitetin dhe autoritetin e universitetit.

Do ta kthejmë autonominë e universitetit, jo nga shkak që profesorët duhet të gëzojnë privilegje më të mëdha, por nga shkak që nga universitetet dalin ndryshimet shoqërore progresive dhe idetë e lirisë, aty kontrollohen dhe barten njohuritë ekzistuese dhe krijohen njohuritë e reja. Për këtë arsye, imperativi ynë do të jetë investimi në shkencë dhe në punën akademike. Qeveria do të propozojë një mënyrë të re të financimit dhe menaxhimit me universitetet. Ligji për arsim të lartë do të pësojë revizion të plotë, me mundësinë për të miratuar krejtësisht ligj të ri për arsimin e lartë, në debatin e gjerë. Do të ndërpriten dispozitat e dënimit të lartë, që tani shfrytëzohen për frikësimin e kuadrit universitar dhe për kufizimin e autonomisë universitare.

Sigurimi i cilësisë në arsimin e lartë do të jetë prioritet i lartë. Në partneritetin me bashkësinë akademike, do të revidohet sistemi për akreditimin dhe evalvimin universitar, në pajtim me standardet dhe drejtimit evropiane për sigurimin e cilësisë, me vëmendje të posaçme në profesionet e rregulluara dhe në arsimin e lartë profesional. Nëpër prizmin e këtyre standardeve, do të rishqyrtohet cilësia e studimeve të disperzuara dhe universiteteve private, si dhe arsytimi dhe nevoja e tyre ekonomike shoqërore.

Moskujdesi për cilësinë e arsimit të lartë shpie në hiperproduksionin e diplomave, pa njohuri dhe shkathtësi konkurrencte. Rezultatet nga hulumtimet sugjerojnë në studimin e prolonguar, procesin mësimor të dimensionuar joadekuatë dhe cilësinë mesatare të studimeve. Obligimi ynë do të jetë mbështetja e universiteteve dhe fakulteteve që të ndërpriten keqpërdorimet që bëhen në kurriz të studentëve dhe prindërve.

Qeveria do të mundësojë pavarësi juridike dhe operative në Këshillin e Akreditimit dhe Evalvimit, si parakushte themelore për përmbushjen e kritereve për marrjen e statusit të anëtares së plotë në ENQA (Asociacioni Evropian i Agjencive Nacionale për Sigurimin e cilësisë në arsimin e Lartë) dhe EQAR (Regjistri Evropian i Agjencive për Sigurimin e cilësisë në arsimin e Lartë).

Universitetet duhet t'u kthehen profesorëve dhe studentëve, e jo të shfrytëzohen për ndikim politik dhe partiak në zbatimin e politikës së tyre kadrovike, shkencore dhe mësimore. Është koha që universitetet shtetërore vërtetë të reformohen, por jo përmes centralizimit të veprimtarisë dhe funksioneve, por përmes menaxhimit më demokratik dhe më transparent dhe dhënies më tepër „pushtet“ të prekurve të drejtpërdrejtë në procesin e arsimit të lartë: profesorëve, institucioneve të tyre amë dhe studentëve. Autorizimet e rektorëve, dekanëve dhe drejtorëve duhet t'i nënshtrohen rishqyrtimit, e jo si tani të jenë të përqendruara dhe ekzekutive.

Studentëve më të mirë të diplomuar do t'u japim mundësi, në veprimtarinë e mentorit të mësimdhënësve më me përvojë, të jenë vullnetarë si kuadër mësimor në arsimin fillor dhe në arsimin e mesëm, në periudhën prej 1-2 vjet. Studentët më të mirë duhet të punësohen dhe të stimulohet qëndrimi i tyre në Republikën e Maqedonisë. Kjo do të kontribuojë për ngritjen e cilësisë së procesit mësimor dhe përtëritjen e kuadrit mësimor.

Qeveria do ta mbështesë hapjen e sërishme të lektorateve për gjuhën maqedonase në universitetet e huaja në vendet tjera, veçanërisht në vendet e BE-së. Do të mbahet përkujdesje e madhe për përdorimin me rregull të gjuhës amtare nga të gjithë faktorët dhe veprimtarët që kanë ndikim në opinion (mediat, operatorët e telekomunikimit, organet shtetërore dhe institucionet) me theks të veçantë në përdorimin me rregull të gjuhës qysh në popullsinë e re në fillim të procesit arsimor.

Qeveria do të fillojë ndërtimin e qytetit të studentëve në Shkup, me zgjidhje komplet të reja dhe moderne arkitektonike dhe hortikulture, si dhe përmbajtje funksionale: salla sportive, salla leximi, biblioteka, restorante, salla të kinemasë dhe qendra të fitnesit. Gjithashtu, Qeveria do ta përfundojë ndërtimin e kompleksit universitar „Nëna Terezë“. Në mënyrë plotësuese, Qeveria do të ndërtojë godinë të re studentore në Autokomandë me mbi 700 shtretër përmes partneritetit privat publik. Në Manastir, Shtip dhe Tetovë, qytetet seli të universiteteve shtetërore, do të ndërtojmë kampe universitare, përmes rikonstruksionit dhe ripërshtatjes së objekteve ekzistuese, ndërtim plotësues të përmbajtjeve të reja infrastrukturore përkatëse dhe rritjen e kapacitetit të konvikteve ekzistuese.

Ndryshimet në arsim duhet të shkojnë paralelisht me përmirësimin e kushteve fizike ku mësojnë fëmijët tanë. Çdo vit, Qeveria do ta debatojë fondin për investime në infrastrukturë me komunat dhe do të miratojë vendim për prioritetet që nuk do të bazohet në interesat partiake dhe të biznesit, por në interesat e nxënësve dhe mësimdhënësve në Republikën e Maqedonisë. Do të ndërtojmë shkolla të reja të mesme në Komunën e Tetovës, Komunën e Aerodromit dhe Komunën e Novo Sellës.

Qeveria do të fut sistemin e mësimin të përjetshëm sipas standardeve evropiane, pjesërisht me përdorimin edhe të fondeve dhe programeve evropiane që dedikohen pikërisht për këtë qëllim. Me këtë koncept do të përpiqemi të ndërtojmë një shoqëri e cila ofron mundësi të barabarta për qasje në mësimin cilësor për të gjithë personat, gjatë tërë jetës. Me të do të mundësohet rikualifikimi në punën e qytetarit, mundësia për kreativitet më të madh, hapja e bizneseve personale, si dhe zvogëlimi i presionit social.

### **Mbështetje për të rinjtë**

Qeveria do të drejtojë politikë të rinisë e cila do të jetë thelbi i politikave për vetëpunësim, për reforma në arsim, shëndetësi, kulturë, sport, etj. Në politikat e Qeverisë, theksi kryesor do të vendoset në masat me të cilat do të përmirësohen jeta dhe standardet studentore, ndërsa të rinjtë do të arrijnë më lehtë te punësimi i parë. Qëllimi ynë me prioritet është që të rinjtë të projektojnë dhe të ndërtojnë të ardhmen në atdheun e tyre.

Qeveria do të vendosë kartelë të veçantë pagese për shfrytëzimin e shërbimeve në kampet studentore, lirime për shfrytëzimin e transportit ndërqytetor, lirime gjatë vizitës së të gjitha institucioneve shtetërore dhe nacionale, lirime për vizitën e ngjarjeve sportive dhe kulturore me karakter nacional.

Politika e re për dhënie të bursës për studentë do të jetë një kombinim i bursave shtetërore dhe nxitje të lehtësimeve fiskale për firmat që do të ndajnë përqindje nga fitimi për dhënie të bursës. Përparësi do të kenë studentët me rezultate më të mira, por edhe ata që përballen me probleme të mëdha ekonomike dhe sociale.

Qeveria do të hap dialog me studentët rreth mënyrave për departizim dhe pluralizëm në organizimin studentor, duke mundësuar pjesëmarrje thelbësore të studentëve në organet e menaxhimit të universiteteve dhe ndikim në çështjet të interesit të tyre. Në bashkëpunim me ta, Qeveria do të promovojë projektin rajonal për shkëmbimin e studentëve.

Qeveria do të iniciojë organizimin e garave shtetërore në dhjetë kategori të ndryshme dhe olimpiadë për shkolla të mesme në stilin e Lojërave Rinore Studentore, ku nxënësit më të talentuar të shkollave të mesme do të garojnë në disiplina olimpike. Në këtë mënyrë, do të krijojmë talentet e reja të suksesshëm, do të zhvillojmë njohurinë dhe shpirtin sportiv dhe do të sigurojmë shoqëri midis nxënësve të shkollave të mesme nga i gjithë shteti.

Qeveria do të krijojë kushte për zmadhimin e numrit të orëve të sportit në shkollat fillore dhe të mesme: stërvitje, trajnime dhe gara në pothuajse të gjitha sportet. Qëllimi ynë është që të gjithë nxënësit të kenë mundësi të shoqërohen dhe të jetojnë një jetë të shëndetshme pa u bërë ngarkesë financiare për prindërit e tyre.



## Shëndetësi cilësore

Qeveria e Republikës së Maqedonisë do të synojë ndërtimin e një sistemi të qëndrueshëm afatgjatë dhe financiar, cilësor dhe qasës të mbrojtjes shëndetësore, me qytetarët në qendër të sistemit shëndetësor dhe një ndjenjë dhe përgjegjësi të përfortuar të individit për shëndetin e tij dhe për shëndetin e të tjerëve.

Puna e zmadhuar administrative e punonjësve të shëndetësisë do të zvogëlohet, ndërsa kujdesi për pacientët do të vihet në qendër të vëmendjes. Qeveria do të propozojë heqjen e participimit për mjekim spitalor. Sistemi shëndetësor në Maqedoni do të ndërlidhet në një sistem të integruar informativ dhe do të themelohet një rrjet i institucioneve shëndetësore me përfshirje të plotë të ambulancave, veçanërisht në mjediset suburbane dhe rurale.

Për të parandaluar largimin e personelit mjekësor nga shëndetësia publike, Qeveria do të sigurojë kushte normale për punën e tyre dhe paga më të larta. Me paga më të larta, mundësi më të mëdha për specializim dhe me përmirësimin e kushteve për praktikë mjekësore do të krijojmë një atmosferë në të cilën shumica e mjekëve do të kenë dëshirë për të qëndruar në Maqedoni.

Organizim i mirë i veprimtarisë shëndetësore është ai që i jep përparësi mbrojtjes shëndetësore parandaluese dhe primare. Në **mbrojtjen shëndetësore parandaluese** Qeveria do të angazhohet dhe do të kontribuojë për: ruajtjen dhe avancimin e shëndetit në përmirësimin e gjendjes shëndetësore të popullatës, e veçanërisht të grupeve të lëndueshme (fëmijë, shtatzëna, persona të moshuar, të sëmur kronik dhe persona me nevoja të veçanta); edukimin shëndetësor të fëmijëve në shkolla për të përvetësuar stilet e shëndetshme për jetesë (ushqim përkatës, aktivitet fizik, parandalim të varësisë nga duhani, alkooli dhe substancat psikoaktive, parandalim të sëmundjeve seksualisht të transmetueshme, HIV/SIDA dhe probleme në lidhje me shëndetin mental); debat të gjerë ekspertësh mbi nevojat dhe përfitimet nga vaksinimi, bashkë me furnizimin e vaksinave me cilësi të lartë. Cilësia e jo çmimi do të jenë kriteri kyç; përfortimin e kontrollit të sëmundjeve aktuale ngjitëse që janë me rëndësi për shëndetin e popullatës; masa dhe aktivitete për zvogëlimin e morbiditetit, paaftësisë dhe mortalitetit të parakohshëm të shkaktuara nga sëmundjet më të shpeshta jongjitëse (sëmundjet cerebro-vaskulare, sëmundjet malinje dhe sëmundja e diabetit), nëpërmjet avancimit të shëndetit me aktivitete të organizuara nga qeveria, institucionet shëndetësore, organizatat joqeveritare dhe shoqatat civile; përfortimin e kapaciteteve të mbrojtjes shëndetësore stomatologjike në sistem; realisht e jo vetëm në letër, zbatimi i programeve për zbulimin e hershëm të sëmundjeve malinje, për diagnostikimin e tyre në fazën fillestare.

Në mbrojtjen shëndetësore primare, Qeveria do të punojë në përmbushjen e këtyre qëllimeve dhe politikave: sigurim i gjinekologut amë për çdo grua në Maqedoni; pacientët amë do të regjistrohen në ordinanca, duke përcaktuar numrin maksimal të pacientëve të regjistruar për një mjek dhe pagën e përcaktuar dhe të garantuar minimale për çdo mjek plotësues; rritje të pikëve të kapitacionit të mjekëve amë në 90 denarë; vendosje të hartës mjekësore të të gjitha institucioneve ekzistuese shëndetësore në Maqedoni dhe liberalizim të rrjetit, përkatësisht heqjen e së drejtës të ministrit që të jep leje për hapje dhe të Fondit për të marrë vendime nëse do të nënshkruaj marrëveshje me një ordinancë e cila i ka përmbushur kushtet e punës në pajtim me kriteret që do të vlejnjë në mënyrë të barabartë për të gjithë; formim të një Fondi për financimin e mjekimit jashtë vendit të fëmijëve deri në moshën 18 vjet i cili do të duhet që urgjentisht t'i merr vendimet e domosdoshme pa presione politike

dhe të ministrit. Kështu mjekimi i fëmijëve në Maqedoni nuk do të varet nga humanizmi i qytetarëve të saj.

Në kuadër të politikës shëndetësore, Qeveria do të themelojë institucion të ri dhe të pavarur publik shëndetësor të ndihmës urgjente mjekësore, i cili do t'i bashkojë të gjitha shërbimet e ndihmës urgjente mjekësore dhe do të lidh të gjitha spitaleve në Republikën e Maqedonisë.

Qeveria menjëherë do t'i fillojë përgatitjet për vendosjen e mjekimit falas spitalor për të gjithë personat e siguruar shëndetësor. Gjithashtu, do të fillojë edhe një proces gradual i rritjes së pagës bazë të të gjithë punëtorëve të shëndetësisë. Pagat themelore të të gjithë punëtorëve shëndetësor do të dyfishohen deri në fund të mandatit. Deri në vitin 2020 pagat e mjekëve specialist në shëndetësinë terciare gradualisht do të shënojnë rritje dhe do të arrijnë një minimum prej 100.000 denarë, përkatësisht 1.600 euro. „Termini im“ do të zëvendësohet me një sistem i cili do të garantojë mbrojtje shëndetësore cilësore dhe të shpejtë në çdo nivel, me afate dhe obligime saktë të përcaktuara. Sistemi i ri në mënyrë drastike do të reduktojë kohën për obligimet administrative të mjekëve.

Në pjesën e kapaciteteve, Qeveria do të punojë në vënien në funksion të qendrës për trajtimin e thembrës diabetike në kuadër të Spitalit të përgjithshëm të qytetit „8shtatori“; në hapjen e Spitalit të përgjithshëm të fëmijëve në Shkup me Qendër emergjente; në hapjen e qendrës për diagnostikim në kohë dhe trajtim të sëmundjeve seksualisht të transmetuara me një personel multidisiplinar, me qëllim që të zvogëlohen komplikimet siç janë steriliteti dhe sëmundjet malinje; në fillimin e rikonstruksionit dhe furnizimit (duke përfshirë edhe kuadrin e domosdoshëm) të spitaleve të përgjithshme dhe klinike në Maqedoni, si dhe shtëpitë përkatëse shëndetësore, poliklinikat dhe ambulancat (Negotinë, Çashkë, Rankovce, Haraçinë, Draçevë, Lisiçe, Çair dhe Novaci).

Qeveria e Republikës së Maqedonisë do të sigurojë ndërtimin e një Qendre universitare klinike të re, bashkëkohore dhe funksionale në Shkup, e cila do të garantojë shërbime cilësore shëndetësore të popullatës në të gjithë shtetin dhe do ta kthejë konceptin e Qendrës universitare klinike të vetme ku klinikat do të lidhen në mënyrë funksionale.

Për të zmadhuar numrin e specialistëve në shëndetësinë shtetërore, do të vendoset specializim për 10 studentët më të mirë të çdo gjenerate dhe do të zmadhohen kuotat e specializimeve shtetërore. Do t'u japim përparësi specializimeve deficitare sipas nevojave të institucioneve shëndetësore dhe sipas rajoneve. Gjatë specializimit, specializantëve privat do t'u sigurohen paga dhe kontribute në lartësi të pagës së garantuar minimale për një mjek të përgjithshëm.

Në bashkëpunim të ngushtë me shoqatat e prindërve për fëmijë me sëmundje të rralla dhe nevoja të veçanta, Qeveria do të propozojë rregullore të reja ligjore me të cilat do të mundësojë që kujdesi për këtë kategori të ndjeshme të jetë gjithëpërfshirës dhe më i sigurt.

Në pjesën e stomatologjisë, Qeveria do të iniciojë rritjen e kapitacionit për një pacient për stomatologët amë dhe pako themelore falas stomatologjike për fëmijë deri në moshën 18 vjeçare.

Qeveria do të punojë për të kapërcyer situatën e mungesës së barnave me recetë pas datës 15 të muajit dhe rritjen e rezervave dhe aksesit të barnave. Do të krijohet një sistem për të pamundësuar keqpërdorimin e recetave të dhëna dhe shpenzimin fiktiv të kuotave mujore për furnizim të barnave. Furnizimi në kohë i insulinës për të sëmurit me



diabet në nivel vjetor do të parandalojë transferimin e pacientëve nga insulina analoge në atë human. Lista e barnave të mbuluara nga FSShM do të rishikohet një herë në vit, me vendosjen e barnave të reja në listë dhe me përfaqësimin e garantuar të të gjitha barnave nga lista esenciale e barnave. Qeveria do të angazhohet që të paktën një lloj i kontraktivëve oral të vendoset në listën pozitive.

Qeveria do të sigurojë subvencionimin e veprimtarisë farmaceutike në zonat rurale nëpërmjet pagesës tre-vjeçare të qirasë së përcaktuar për hapësirë afariste, subvencionimin e detyrimeve për sigurim shëndetësor dhe pensional për periudhë tre-vjeçare dhe kompensim të shpenzimeve për rrugë nëse farmacisti jeton në një distancë më të madhe se 20 kilometra nga barnatorja.

Do të përcaktohet kornizë e re për import paralel që do të përputhet me rolin dhe me funksionin e tij, ndërsa në pajtim me modelin që zbatohet në vendet e BE-së dhe do të vendoset një metodologji objektive, transparente dhe ndërkombëtarisht e vërtetuar për formimin e çmimeve të vetme të barnave në Republikën e Maqedonisë.

Gjatë zgjedhjes së barnave dhe gjatë shpalljes së tenderëve për të njëjtat në trupat do të marrin pjesë edhe përfaqësues të shoqatave përkatëse civile nga fusha e mbrojtjes shëndetësore, si dhe të klubeve dhe shoqatave të të sëmurëve (sëmundja e diabetit, hemodializa, hipertensioni, kanceri i gjirit, infeksioni HIV), si dhe të pacientëve me sëmundje të rralla, pacientë nga komunitetet të margjinalizuar dhe pacientë me nevoja të veçanta. Në këtë mënyrë, shteti do të kontrollohet pikërisht nga shfrytëzuesit e fundit dhe do të sigurohet zgjedhja e barnave cilësore dhe veglave ndihmëse mjekësore me një çmim më të mirë të mundshëm.

Qeveria urgjentisht do të përgatit Plan aksionar për konsolidim financiar të institucioneve publike shëndetësore dhe propozim për shfrytëzimin e resurseve të spitaleve private, për shërbime që aktualisht nuk ekzistojnë në shëndetësinë publike, nëpërmjet lidhjes së marrëveshjeve.

### **Administrata publike si servis**

Qeveria e Republikës së Maqedonisë do të punojë në krijimin e një administrate profesionale dhe efikase, llogaridhënëse dhe transparente e cila do të sigurojë shërbime cilësore për qytetarët dhe sektorin e biznesit dhe do t'i mbrojë të drejtat e tyre. Me zbatimin e parimeve të drejtësisë dhe profesionalizmit gjatë avancimit dhe shpërblimit të të punësuarve në administratë, Qeveria e Republikës së Maqedonisë do të krijojë një administratë, e cila do të çlirohet nga prangat partiake dhe do t'i përkushtohet zgjidhjes së problemit të qytetarëve dhe subjekteve afariste, duke e respektuar parimin e ligjshmërisë dhe paanshmërisë gjatë ushtrimit të detyrës.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë do të propozojë strategji të re për reforma në administratë dhe do të themelojë Qendër të Përsosmërisë e cila do të bëjë analizë dhe notim real dhe të pavarur të politikave publike dhe do të propozojë metoda dhe mënyra të reja për përmirësimin e punës së institucioneve dhe administratës.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë me përkushtim do të punojë në realizimin e vlerës themelore të rendit kushtetues - përfaqësimin adekuat dhe të drejtë të qytetarëve i të gjitha bashkësive, në organet e pushtetit shtetëror dhe institucionet e tjera publike në të gjitha nivelet, si në kompanitë publike ashtu edhe ato shtetërore.

Qeveria urgjentisht do të zgjedh problemin me nëpunësit shtetëror të cilët një kohë të gjatë marrin pagë, ndërsa nuk janë të sistematizuar në vende pune. Ekziston pakën-

aqësi e arsyeshme edhe nga ana e tyre por, edhe nga ana e publikut për praktikën e tillë. Qeveria do të krijojë një administratë e cila me përkushtim do të punojë në shërbim të qytetarëve dhe e cila do të shpërblehet për angazhimin e saj në favor të qytetarëve, e jo për shkak të përkatësisë partiake ose ndonjë përkatësie tjetër. Për këtë shkak, Qeveria menjëherë do t'i shpall të dhënat për numrin e nëpunësve shtetëror të pa sistematizuar dhe do të miratojë plan për sistematizimin e tyre urgjent në vende pune dhe për angazhimin profesional.

Në kuadër të reformave në administratë, Qeveria e Republikës së Maqedonisë parasheh:

- Themelimin e Regjistrimit publik të administratës në të cilin do të shpallet numri i përgjithshëm i të punësuarve të përhershëm dhe të përkohshëm në sektorin publik. Regjistri do të jetë në dispozicion të publikut dhe do të azhurnohet rregullisht. Qytetarët do të kenë këqyrje të të gjithë të punësuarve në administratën publike, për çdo institucion.
- Punësime pa shpenzime të panevojshme, duke propozuar ndryshime ligjore që dokumentet e nevojshme për pjesëmarrje në një shpallje publike për punësim që kandidati duhet t'i sigurojë nga institucione të tjera, me detyrë zyrtare t'i sigurojë institucioni i cili e zbaton procedurën. Për të njëjtat arsye, do të propozohet heqja e testit të personalitetit (testi psikologjik) si kusht i punësimit.
- Vendorsjen e orarit fleksibël të punës së institucioneve që fillon nga ora 7:30 deri në orën 8.30 në mëngjes dhe do të zgjat deri në orën 15.30, përkatësisht deri në orën 16:30 pasdite. Përveç kësaj, në një institucion do të bëjmë pilot projekt për 6 orë orar pune, me qëllim që të përcaktohen efektet mbi produktivitetin në punë.
- Institucionet që kanë një sasi të konsiderueshme të punës dhe ku qytetarët i realizojnë të drejtat kryesore, të punojnë në dy turne, përkatësisht deri në 20 orë, që të mund të sigurojnë shërbim në kohë për të gjithë qytetarët.
- Fillimin e procesit të konsultimeve të gjera me palët e interesuara për themelimin e një sistemi të ri të vlerësimit në sektorin publik. Vlerësimi do të bëhet sipas parametrave që janë të dukshme dhe mund të maten siç janë: rregullshmëria në punë, efektiviteti, profesionalizmi dhe ekspertiza gjatë kryerjes së detyrave të punës.
- Rritjen e pagave në sektorin publik në bazë të rritjes së ekonomisë maqedonase. Të punësuarit në sektorin publik do të shpërblehen për arritjen e rezultateve të jashtëzakonshme dhe për përkushtimin më të madh në punë.
- Rishikimin e sistemit ekzistues të trajnimeve dhe futjen e sistemit të trajnimeve edhe për persona të zgjedhur dhe të emëruar.
- Vendorsjen e një sistemi të vetëm elektronik me të cilin do të lidhen të gjitha institucionet e shtetit. Këtë sistem elektronik do ta shfrytëzojnë të gjitha aplikacionet për dhënien e shërbimeve publike të cilat shteti ua ofron qytetarëve. Gjatë kësaj, çdo qytetar do të merr nënshkrim të vetëm digjital për paraqitje gjatë shfrytëzimit të të gjitha aplikacioneve, sipas modelit të shteteve skandinave. Me këtë, do të sigurojmë kontroll të lehtë në dhënien e shërbimeve për të gjithë qytetarët, ndërsa në të njëjtën kohë do t'i japim fund pritjes në radhë dhe

- dhënies së mitos ndaj nëpunësve kompetent administrativ. Ky vendim tërësisht do të vihet në përdorim në vitin e tretë të mandatit. Në ndërkohë, në 180 ditët e para të mandatit Qeveria do t'i eliminojë të gjitha dokumentet e panevojshme, ndërsa çmimi i përgjithshëm i shërbimeve do të paraqitet në mënyrë të qartë; do të sigurojmë dhënie të plotë elektronike të 50 vërtetimeve ose dokumenteve të lëshuara zakonisht, ndërsa në çdo gjashtë muaj, do të shënojë rritje për 10% numri i e-shërbimeve që institucionet ua ofrojnë qytetarëve.
- Propozimin e ndryshimeve ligjore për sigurimin e procedurave të shkurtra dhe efikase administrative, kështu që për çdo procedurë në mënyrë publike dhe veç e veç do të shpallen hapat në procedurë dhe cilët nëpunës janë të angazhuar për të vepruar; ndërsa të gjitha kundërvajtjet do të sanksionohen, me çka në Inspektoratin Shtetëror Administrativ do të vendoset një linjë telefonike ku qytetarët dhe kompanitë do të mund të paraqesin dyshim për një kundërvajtje të kryer.

## Investime për rritje të qëndrueshme

### Zhvillimi i bujqësisë

Prioriteti i Qeverisë është zmadhimi i sipërfaqeve bujqësore dhe i kontributit dhe cilësisë së prodhimeve bujqësore. Kjo do të thotë edhe të hyra më të larta në të gjitha familjet që merren me bujqësi dhe blegtori. Politika do të orientohet edhe ndaj zmadhimit të kapaciteteve industriale - përpunuese që do të orientohen drejt eksportit dhe do të krijojnë prodhime me vlerë më të lartë të shtuar. Detyrat më të rëndësishme në fushën e bujqësisë janë: orientimi i subvencioneve bujqësore drejt ekonomive bujqësore fitimprurëse dhe të orientuara ndaj tregut; transparencë të mjeteve buxhetore nga programi nacional për bujqësi dhe zhvillim rural; konsolidim dhe zmadhim të tokës bujqësore për ekonomi dhe integrim horizontal të subjekteve në sektorin e bujqësisë dhe të ushqimit dhe formimit të kooperativave.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë do të sigurojë mbështetje financiare për bujqësinë në shumë prej 160 milion euro. Përveç kësaj, stimulimet plotësuese financiare do të jenë në dispozicion për zmadhimin e sipërfaqeve bujqësore dhe të bagëtisë kryesore. Mbështetja e zmadhuar do të zhvillohet paralelisht edhe me drejtësinë dhe transparencën e zmadhuar me qëllim që mjetet të shkojnë tek bujqit dhe blegtorët e duhur. Për këtë qëllim, plotësisht do të vihet në përdorim sistemi i cili në bazë të incizimeve të ajrit, do ta përcaktojë gjendjen aktuale të tokës bujqësore, kështu që do të zvogëlohen mundësitë për keqpërdorim. Gjithashtu, sistemi do të ndryshohet për të përshpejtuar dhe thjeshtëzuar procedurat për dhënie e subvencioneve dhe qasjen më të lehtë në fondet e BE-së për zhvillim rural.

Në pajtim me reformat e parapara në sistemin tatimor, qytetarët të cilët si veprimtari themelore e kanë bujqësinë dhe i përmbushin kushtet për tatimin paushall, do të lirohen nga pagesa e tatimit.

Do të mundësohet që popullata më e moshuar bujqësore, me stazh prej 15 vite dhe me moshë prej 64 vite, të jetë shfrytëzues i pensionit.

Qeveria do të vendos subvencione për naftën për mekanizimin bujqësor me mekanizëm për parandalimin e keqpërdorimeve të mundshme.

Qeveria do të parasheh obligim që pagesa e prodhimeve të grumbulluara bujqësore të bëhet më së voni 90 ditë pas blerjes së realizuar. Në ligj do të vendoset obligim për garanci bankare për blerjen e planifikuar të prodhimeve bujqësore. Për këtë qëllim, Qeveria do të ndërmjetësojë në negociatat midis prodhuesve dhe grumbulluesve të prodhimeve bujqësore (grurë, oriz, kultura të kopshtarisë, fruta, rrush dhe të tjera) dhe për ato do të caktojë blerjen dhe çmimet e blerjes më së voni 30 ditë para fillimit të blerjes.

Në lidhje me tokën bujqësore, Qeveria do të ndërmerr këto masa dhe aktivitete:

- Rishikim i tokës së dhënë shtetërore bujqësore dhe kategorizim i tokës në bazë të cilësisë, nga e cila do të varet madhësia dhe kohëzgjatja e koncesionit.
- Rajonizim i bujqësisë sipas kushteve të tokës dhe ato klimatike të rajoneve për prodhimtari të planifikuar bimore dhe blegtorale dhe përpilim të listave të kulturave dhe llojeve të rekomanduara, duke i pasur parasysh edhe prodhimet tradicionale.

- Rritja e tokës bujqësore do të bëhet nëpërmjet proceseve të këmbimit të parcelave me ose pa ndryshimin e formës së tyre, deri në ndryshimin e kufijve të parcelave tokësore që të fitohen sipërfaqe tokësore e zmadhuara me formë të duhur, e përshtatshme për prodhim bujqësor.
- Përveç kësaj, sipërfaqet që mund të përpunohen do të zmadhohen duke investuar në sistemet hidromeliorative.

Qeveria do të vendos mundësi për mbështetje të zmadhuar financiare për bujqit deri në moshën 35 vjeçare, deri në pesë vjet nga periudha e fillimit me veprimtarinë bujqësore. Bujqit e rinj deri në 35 vite do të lirohen nga qiramarrja e tokës shtetërore bujqësore në periudhë prej 3 vite dhe do të sigurohet pjesëmarrje më e madhe e shtetit në shpenzimet për mekanizëm bujqësor. Për shfrytëzimin më të lehtë të mjeteve IP-ARD, Qeveria do të vendos mbështetje financiare për interesin e kredive të marra nga bankat komerciale të dedikuara për investime nga programet IPARD.

Qeveria do të vendos masa për stimulimin e prodhimit të ushqimit për bagëti, kultura alternative, prodhimtarinë organike, material për mbjellje i prodhuar dhe i plasuar nga kultura të kopshtarisë, prodhimin e kategorisë më të lartë të materialit për mbjellje, ndërtimin e infrastrukturës deri te fermat malore që kanë qasje të vështirësuar. Do të nxitet ndërtimi i kapaciteteve magazinore bashkëkohore dhe i qendrave për blerje dhe shpërndarje në zonat prodhuese për prodhime specifike të bujqësisë me kapacitet i cili do të jetë mbi 5.000 tonelata, si dhe krijimin dhe mbrojtjen e prodhimeve me markë të njohur, shenjë për cilësinë ose prejardhjen gjeografike.

Qeveria do të propozojë ndryshimin e Ligjit për duhan ku blerja e duhanit do të rregullohet duke u klasifikuar në tre klasa cilësore dhe sipas përfaqësimit në përqindje të vjeljes (e ulët, e mesme dhe e lartë).

Përkrahja për zhvillimin e industrisë së përpunimit do të realizohet nëpërmjet bashkëfinancimit të ndërtimit dhe rikonstruksionit të objekteve prodhuese, furnizimit të pajisjes për kantinat e verës, përpunimit të frutave dhe perimeve, përpunimit të qumështit dhe prodhimit të produkteve të qumështit. Si pjesë e kësaj politike, do të jepen lokacione në tokën e urbanizuar shtetërore në rajonet më të mëdha të prodhimit (Strumicë, Valandovë, Gjevgjeli, Manastir, Prilep, Rosoman, Berovë, Resnjë, Ohër, Tetovë, dhe në rajone të tjera).

Me qëllim që të zmadhohet cilësia e produkteve, Qeveria do të mbështetë instalimin e stacioneve digjitale hidrometeorologjike në çdo rajon prodhues. Do të garantohet mbrojtje më e sigurt dhe më e lirë e mbjelljeve dhe plantacioneve për të reduktuar përdorimin e pesticideve. Në këtë drejtim, do ta përforcojmë kontrollin gjatë importit dhe shitjes së pesticideve.

Në blegtori, do të inkurajojmë dhënien e tokës bujqësore shtetërore blegtorëve të duhur, rritje për 20% të subvencioneve bazë për blegtorët e regjistruar me qëllim që të stimulohet zhvillimi dhe profesionalizmi në blegtori si veprimtari themelore, përkrahje financiare për fermerët e rinj gjatë blerjes së bagëtisë së parë, zmadhim të mbështetjes së prodhuesve të qumështit dhe përkrahje për inseminim artificial të deleve dhe fitimin e prodhimit të sinkronizuar të qengjit, i konfeksionuar sipas peshës për eksport në BE.

Shëndeti i kafshëve është faktori kyç në sigurimin e ushqimit të shëndetshëm të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë dhe në zmadhimin e eksportit. Do të ulet shkalla e TVSh-së për barna veterinarë, do ta ndërmarrim regjistrimin e preparateve vet-

erinare-mjekësore nga BE-ja, do ta subvencionojmë vendosjen e metodave të reja të akredituara dhe akreditimin e laboratorëve që merren me kontrollin e sigurisë së ushqimit për eksport dhe për tregun e brendshëm.

Do të formojmë fondin e ndërhyrjes i dedikuar për sektorin bujqësor-ushqimor për stabilizimin e të hyrave të bujqve si kompensim gjatë rënies së konsiderueshme të tyre.

Qeveria do ta zbatojë Strategjinë për zhvillim të qëndrueshëm të pylltarisë në Republikën e Maqedonisë, me pjesëmarrjen e të gjithë faktorëve relevant nga sfera e pylltarisë dhe gjuetisë, si dhe të qytetarëve nëpërmjet organizatave joqeveritare. Në këtë drejtim, do të transformohet NP „Pyjet e Maqedonisë” në drejtim të udhëheqjes së përgjegjshme, zmadhimit të produktivitetit dhe rezultateve të konsiderueshme financiare.

Një objektiv i rëndësishëm i Qeverisë do të jetë rritja e fondit të pyjeve në Republikën e Maqedonisë dhe ruajtja shumë më cilësore e pyjeve dhe mbrojtja nga prerja e paligjshme me kalimin e sektorit për polici pyjore nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave, në kompetencë të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

## **Infrastruktura**

Niveli i investimeve në infrastrukturën në Maqedoni ka qenë i ulët 10 vite, dhe Maqedonia u bë vend i prapambetur në aspektin infrastrukturor, me mjedise rurale pa kushte themelore për jetë, pa sisteme për furnizim me ujë, pa kanalizime atmosferike dhe fekale. Rrugët u bënë të rrezikshme dhe të pasigurta, (bile 39% prej tyre si jashtëzakonisht të pasigurta sipas BE-së), ndërsa me vonesë shumë të madhe ndërtohen vetëm disa nga akset rrugore.

Prandaj Qeveria e re do të fokusohet në ndërtimin e infrastrukturës që do të shënojë ardhmëri për ekonominë maqedonase, ndërsa do t'i stopojë (ndërpresë) investimet në projekte joproductive, si Shkupi 2014. Qeveria do t'i miratojë vendimet për investime të mëdha në infrastrukturë në mënyrë transparente dhe në konsultim me qytetarët dhe ekspertët relevantë.

Qeveria si qëllime të saj vendos realizimin e projekteve: “Maqedonia megalopolis”, lidhja infrastrukturore ndërmjet qendrave më të mëdha për jo më shumë se 90 minuta, “Maqedonia pa pika të zeza” dhe “Maqedonia pa baltë”.

Qeveria, në pajtim me Ligjin për akciza për karburantet, regjistrimin e automjeteve dhe pagesën rrugore, në mënyrë transparente do t'i shfrytëzojë financat për investime dhe mirëmbajtje të infrastrukturës rrugore. Qeveria do të formojë kompani me pronësi shtetërore dominuese (51%) përmes të cilës do të realizohen investime në projekte infrastrukturore dhe në burime regjeneruese të energjisë. Madhësia fillestare e kompanisë do të jetë 300 milionë euro.

Qeveria do të iniciojë negociata për financim të 3 projekteve infrastrukturore me prioritet nëpërmjet nismës 16 vende të Evropës plus Kinën me vlerë mbi 10 miliardë dollarë.

Qeveria do të miratojë plan për investime në infrastrukturë prej 3 miliardë euro në 10 vitet e ardhshme me çka do të rritet mungesa e tanishme financiare për mirëmbajtje të rrugëve. Përmes këtyre investimeve, Qeveria do të sigurojë 600 kilometra ndërtim të autostradave dhe rrugëve ekspres, 550 kilometra rrugë magjistrale dhe rajonale dhe 1000 kilometra rrugë lokale. Pjesë të akseve rrugore me prioritet do të jenë:

- Autostrada Shkup – Bllace (Kufiri me Kosovën),
- Rikonstruksioni i rrugës rajonale Draçevë – Oreshan-
- Taor dhe rruga rajonale Draçevë Jurumleri
- Ndërtimi i plotë i rrugës rajonale R-302 nga Kisella Voda deri në rrugën rajonale R-104 te vendi Bërzovec
- Ndërtimi i korridorit nëntokësor në qendrën e Shkupit në vijën Qeveri - Kompleks bankash
- Ndërtimi i rrugëkalimit për lidhje të Komunës së Kisella Vodës me Komunën e Aerodromit në vijën 11 Tetori - Rade Konçar
- Ndërtimi i plotë i rrugës së re Sopishte - Usje - bulevardi Boris Trajkovski”
- Ndërtimi plotësues dhe rikonstruksioni i rrugës rajonale Makedonski Brod – Shkup
- Rruga rajonale Kondovë- Radushë
- Lidhja e Matkës drejtpërdrejtë me autostradën Shkup - Tetovë
- Korridori 8 - (pjesa lindore) Rrankovcë - Kriva Pallankë - Kufiri me Bullgarinë (faza e parë rrugë ekspres),
- Korridori 10 - Rehabilitimi i autostradës Milladinovcë - Kumanovë
- Ndërtimi i rrugës rajonale Mateç - Likovë, Likovë- Belanovce dhe Tanushecë – Debelde,
- Rruga rajonale Mlado Negoriçane- Pelince
- Ndërtim infrastrukturor në zonën industriale Vizbegë
- Rruga rajonale Kumanovë- Shën Nikolla
- Autostrada Milladinovci- Shtip
- Shtip - Radovish - ( rrugë ekspres)
- Shtip – Koçani ( rrugë ekspres)
- Rekonstrukcion dhe rehabilitim i rrugës Koçan- Dellçevë
- Koçani- Probishtip ( unaza Ponikva- Tursko Rudare)
- Rikonstruksioni i aksit rrugor Pekllanska Rekë - Biglla (Vinicë-Dellçevë),
- Rikonstruksioni i rrugës rajonale Veles - Bogomillë,
- Rikonstruktimi i rrugës rajonale Berovë- Strumicë
- Rikonstruktimi i rrugës rajonale Propishtip- Krupishte,
- Rikonstruksioni i rrugës rajonale Berovë- Pehçevë- Dellçevë
- Rruga rajonale Dellçevë- Zvegor,
- Rikonstruksioni i rrugës rajonale Berovë- Vinicë



- Përfundim të ndërtimit të rrugës në urën e lumit Bregallnica në rrugën rajonale Koçan- Zërnovci
- Përkrahje financiare për ndërtimin e pendave të lumit Otinje në Shtip dhe për projektin për ndërtim të urës në lumin Vardar dhe qarkorja në Veles.
- Rruga ekspres Gradsko- Prilep- Mexhitlija
- Studim fizibiliteti për autostradën Prilep- Manastir- Mexhitlija
- Autostrada Demir- Kapija- Smokvicë
- Rehabilitimi i rrugës nacionale Strumicë- Kufiri me Bullgarinë
- Rehabilitimi i autostradës Smokvicë- Gjevgjeli
- Rehabilitimi i autostradës Negotinë- Demir Kapi
- Rruga rajonale Kavadar – Rosoman
- Rruga rajonale Dedeli- Furka- Bogdanci- Gjevgjeli
- Rekonstrukcioni i rrugës rajonale Prilep – Noshpal- Dobrushevo- Novaci
- Autostrada Kërçovë- Ohër, Trebenishtë- Strugë
- Projektimi i qarkores Strugë – Qafthanë dhe nisja e ndërtimit
- Projektimi i autostradës Gostivar- Kërçovë dhe nisja e ndërtimit
- Rekonstrukcioni i qarkores Ohër- Resnje
- Ohër – Peshtan- ( Qeveria do të bëjë ndryshime të projektit ekzistues me qëllim të mbrojtjes së parkun nacional Galiçica)
- Zgjidhje më të mirë për transitin Kërçovë ( në kuadër të autostradës Gostivar- Kërçovë)
- Rekonstrukcion të plotë të rrugës f. Podmolje- Strugë- Kalishtë- Radozhdë ( rruga e vjetër në drejtim Ohër- Strugë) të trasës ekzistuese dhe infrastrukturën plotësuese ( shtigjet për këmbësor dhe biçikleta) me qëllim të sigurimit të qasjes cilësore ndaj kapaciteteve turistike rreth bregut të liqenit. Ku do të respektohet edhe brezi i mbrojtur i Liqenit të Ohrit.
- Rikonstrukcioni i rrugës rajonale Manastir- Demir Hisar
- Rehabilitimi i rrugës rajonale Krushevë – Demir Hisar
- Rehabilitimi i rrugës rajonale Lazhani- Ropotovo- Crnilishte – Dolneni
- Rekonstrukcion dhe zgjerim i rrugës rajonale Dibër- A4
- Bisedime për financime të mundshme të ndërtimit të rrugës së re rajonale Izvor- Garski most
- Përfundim i ndërtimit dhe rikonstrukcioni i rrugës shtetërore P2235, segmenti rrugor Hanet e Mavrovës - f. Mavrovë (vija nga penda e Mavrovës deri në Kanalin e Beliçkut)
- Rekonstrukcioni i rrugës rajonale Tetovë- Kodra e Diellit

- Lidhja me mbikalimin Trebosh me Korridorin 8
- Duke u nisur me rezultatet e studimit fizibiliti për rrugën Tetovë- Prizren, do të shqyrtohen edhe variantet ekonomike të arsyeshme
- Rikonstruksioni i Rrugës rajonale P 2242, Jegunovcë – Zhelinë
- Akset rrugore Dobridoll- Gostivar dhe Gostivar Serbinovë
- Vendosja e rrjetit mbrojtës nga rrëshqitja e tokës në rrugën Bshkov most- Dibër
- Vendosja e rrjetit mbrojtës me tela për mbrojtje nga rrëshqitja e tokës në qarkoren përgjatë rrjedhës së lumit Radika
- Rikonstruksioni i rrugës rajonale P 29274, Leshok - (P 2242) Shemshovë,
- Rikonstruksioni i rrugës rajonale P 2234, lidhja me 1203 në Përshovcë deri në lidhjen P 2242 në Jegunovcë
- Rikonstruksioni i rrugës rajonale Centar Zhupa - Novak

Qeveria do të investojë në projekte për modernizimin e infrastrukturës rrugore, rritjen e sigurisë dhe rrjedhën e trafikut, për uljen e ndotjes si dhe për hulumtim dhe sanim të shkarjeve të tokës, futje të pagesave rrugore elektronike dhe sinjalizim modern dhe Sistem transporti inteligjent (STI). Qeveria do të iniciojë përpunim të dokumentacionit projektues për përcaktimin e segmenteve rrugore me prioritet dhe do t'i realizojë në mënyrë të barabartë sipas rajoneve të planit.

Do të punojmë në ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve të tjera rajonale, të cilat do të përcaktohen plotësisht nëpërmjet programit të Ndërmarrjes Publike për Rrugë Shtetërore (NPRrSh). Njëkohësisht do të përshejtojmë hapjen e pikave kufitare, afër së cilave ndërtohet ose është përfunduar ndërtimi i akseseve rrugore.

Qeveria e re në bashkëpunim me autoritet e vetëqeverisjes lokale do të punojë në ndërtimin dhe rehabilitimin e një numri më të madh të rrugëve lokale nëpër Republikën e Maqedonisë. Njëkohësisht do të ndihmohet edhe në ndërtimin e rrugëve lokale dhe rrugicave për çiklizëm malor, në interes të zhvillimit të turizmit liqenor, malor dhe sportiv.

Qeveria do të investojë në modernizimin e infrastrukturës hekurudhore, përtëritjen e parkut të automjeteve, dhe në sigurinë, si p.sh:

- Projekt për komunikacion periferik udhëtarësh që do të përbëhet prej 4 krahëve në dhe rreth Shkupit
  - Zelenikovë - Draçevë - Lisiçe - Pinti - 11 Tetor – Skopje Patniçka (24 km)
  - Milladinovcë - Ilinden - Maxhari - Shkup Patniçka (19 km),
  - Ndërtimi i hekurudhës së re nga Milladinocë deri në Aeroportin e Petrovecit (5 km),
  - Radushë- Saraj- Gjorçe Petrov- Shkup Veri- Zhelezara- Pivara – Skopje Patniçka
- Elektrifikimi i hekurudhës Shkup - Shkup Veri - Gjorgje Petrov - Volkovë - Bllacë (kufiri me Republikën e Kosovës) dhe Shkup - Kërçovë
- Stacione hekurudhore solare (diellore) - rikonstruktimi dhe modernizimi i stacioneve hekurudhore në Korridorin 10 dhe 10d, Tabanovcë,

- Përfundimi i rekonstruksionit të hekurudhës nga Kumanova deri në Belakovce.
- ( Korridori 8) dhe ndërtimi i hekurudhës së re nga Belakovce deri në Kriva Pallankë ( Korridori 8)
- Faza fillestare e ndërtimit të hekurudhës nga Kriva Pallanka deri në Deve Bair ( faza e tretë në Korridorin 8 nga Kumanova deri në Republikën e Bullgarisë)
- Hartimi i dokumentacionit projektues për ndërtimin e hekurudhës Kërçovë- Lin ( Republika e Shqipërisë) dhe fillim i ndërtimit.
- Studimi fizibiliteti për ndërtimin e krahut hekurudhor deri në Strumicë dhe Republikën e Bullgarisë.
- Rekonstruksioni Veles- Manastir dhe përfundimi i rekonstruksionit Manastir-Kremnicë
- Përpilimi i projekteve themelore dhe i dokumentacionit të nevojshëm teknik për ndërtim dhe mbikëqyrje të hekurudhës së re deri në zonat industriale (krah nga stacioni hekurudhor Milladinocë drejt zonës industriale Bunarxhik)
- Siguri në komunikacion: siguri të akseseseve rrugore të korridorit 8 dhe korridorit 10.
- Stacione hekurudhore diellore- riparimin dhe modernizimin e Korridorit 10 dhe 10 d.

Qeveria do të përpilojë strategji të re nacionale për zhvillim afatgjatë të komunikacionit ajror, do ta analizojë nivelin e realizimit të marrëveshjes koncesionale me operatorin e aeroportit dhe do të punojë në prioritete investuese si lidhja e shpejtë transportuese ndërmjet aeroportit të Shkupit dhe Ohrit dhe promovimi i aeroportit të Ohrit në aeroport low-cost (me kosto të ulët). Do të bëhet analizë të kushteve për themelimin e transportuesit ajror maqedonas, ndërtimin dhe adaptimin e 7 heliodromeve për nevoja mjekësore, policore dhe ushtarake, 4 sipërfaqe të ndara ujore për operim të hidroplanëve për dedikime të veçanta.

Përmes dialogut të hapur të organeve shtetërore me institucione dhe ekspertë të specializuar do të përpilohet propozim për subvencionim të qëndrueshëm të turizmit lidhur me zhvillimin e komunikacionit dhe transportit ajror.

Qeveria do të zhvillojë sistem transparent për ndarje të drejtë të lejeve CEMT, dhe do t'u japë mbështetje dhe siguri kompanive, duke u ofruar kushte për të gjithë pjesëmarrësit. Potenciali për zhvillim do të stimulohet edhe përmes zvogëlimit të çmimit të kartonit të gjelbër.

Qeveria do të propozojë masa dhe dispozita ligjore për përtëritjen e profesionalizmit dhe ligjshmërisë në planifikimin hapësinor, urbanistik dhe veprimtarinë gjeodezike përmes planifikimit transparent dhe human të hapësirës dhe zhvillimit të qyteteve.

Qeveria do të propozojë revizion dhe harmonizim të ligjeve nga sfera përkatëse, masa dhe rregulla për kontroll të objekteve, rritje të sigurisë dhe cilësisë së ndërtimit dhe për zonë të detyrueshme me gjelbërim. Do të duhet doemos të mundësohet qasje reale të qytetarëve gjatë miratimit të planeve urbanistike dhe të jepet mundësi reale për ndikimin e tyre mbi vendimet për atë se çka dhe si do të ndërtohet në mjedisin e tyre. Do të rregullohen në mënyrë ligjore normativat për gjelbërim urban në çdo parcelë

ndërtimore që të mundësohen nevojat e qytetarëve për jetesë human, të shëndoshë dhe cilësor. Do të propozohen stimuj financiarë plotësues në tarifat e Agjencisë së Kadastrës, në kompensimet komunale për ndërtim të objekteve për parkim dhe objekteve tjera publike me interes.

Qeveria do të punojë në zhvillimin dhe ndarjen e barabartë të mjeteve në mjediset rurale dhe do të mundësojë përmirësimin e jetës dhe shëndetit të qytetarëve në ndërtimin e sistemeve të ujësjellësit dhe kanalizimit. Përqindja e mbulimit me kanalizim nga 18% do të arrijë në 40% dhe do të ndihmohet financiarisht. Reformat qeveritare në sektorin komunal do ta përmirësojnë efektivitetin dhe produktivitetin në shërbimet sipas kostos reale të shpenzimeve. Qeveria do të sigurojë mjete dhe stimul financiar nga fondet evropiane dhe nga Buxheti i RM-së.

Qeveria do të sigurojë masa për parandalimin e keqpërdorimeve me banesat sociale përmes subvencioneve për ndërtim (50% nga kompensimi komunal për ndërtimin e shtëpive banesore individuale deri në 150m<sup>2</sup>), subvencione të kamatës nga kreditë për blerje të banesës për çifte të reja martesore, dhe subvencione për projektim dhe ndërtim të objekteve për grupet vulnerable të qytetarëve.

Qeveria do t'i subvencionojë qytetarët për izolim të objekteve me efikasitet energjetik, me 20% të investimit të përgjithshëm. Subvencionet do të sigurojnë deri në 70% kursim të energjisë, shpenzime të zvogëluara, import i zvogëluar i rrymës, ndërsa do të sigurojë vëllim të zmadhuar të punës dhe numrit të të punësuarve në firmat prodhuese dhe realizuese të këtyre materialeve.

## **Energjetika**

Qeveria synon ta kthejë sigurinë dhe stabilitetin e humbur energjetik të Maqedonisë, t'i zvogëlojë shpenzimet për energjinë dhe ta zvogëlojë varfërinë energjetike, ndërsa dielli të bëhet burim i energjisë në amvisëritë.

Qeveria do të sigurojë energji të disponueshme për të gjithë qytetarët dhe ndërmarrjet. Do të stimulohen zgjidhje novatore dhe teknologji të avancuara për prodhim të energjisë, për zvogëlim të pjesëmarrjes të karburanteve fosile, dhe rritje të prodhimit të energjisë nga burime rigjeneruese.

Zvogëlimi i importit të energjisë do të paraqesë rezultat të kombinimit të efikasitetit energjetik dhe kursimit të energjisë, prodhim racional të energjisë personale dhe pjesëmarrje të duhur në tregjet rajonale dhe ndërkombëtare të energjisë elektrike, gazit natyror dhe derivateve të naftës.

Qeveria do të mbështesë prodhimin racional të Energjisë elektrike me ridedikim të TEC Negotinës në kombinatin energjetik-bujqësor, ndërtimin e HEC Çebren dhe HEC Galishte, dhe shfrytëzim optimal të basenit të Pelagonisë për qymyr, implementimin e standardeve ekologjike më bashkëkohore në TEC Manastir dhe TEC Oslomej.

Projekti i Qeverisë për TEC Negotinë do të sigurojë energjens të lirë për kombinatin bujqësor energjetik me çka do të kontribuojë për konkurrencën dhe eksportin e kulturave të hershme dhe hapjen e vendeve të punës në bujqësi. Me ndërtimin e HEC Çebren dhe HEC Galishte, Qeveria do të sigurojë prodhim të zmadhuar vendor dhe import të zvogëluar të energjisë së shtrenjtë. Me fillimin e eksploatimit të bazës së qymyrit në minierën Suvodoll dhe me eksploatim të gropës së qymyrit në minierat Zhivojnë dhe Vitolishtë, Qeveria do ta vazhdojë punën në shtyllën e energjetikës maqedonase, KEM Manastir. Me implementimin e ekostandardeve bashkëkohore në TEC Manastir dhe

TEC Oslomej (instalimi i sistemit të emisioneve dhe stacioneve për desulfurizim) do të zvogëlohet emisioni i grimcave të dëmshme në mjedis në rajonin e Pellagonisë dhe Kërçovës.

Qeveria do të fokusohet në përmbushjen e nevojave elektroenergjetike të vendit me prodhim personal si dhe në përmirësimin e kushteve për punë dhe mbrojtjen në kompanitë energjetike.

Me hapjen e minierës së qymyrit Popovjan dhe modernizimin e TEC Oslomej, Qeveria do ta vazhdojë afatin e prodhimit të elektranës dhe do të sigurojë vende të reja pune në rajonin e Kërçovës.

Qeveria do ta rishqyrtojë vlefshmërinë për ndërtim të kapaciteteve hidroenergjetike përgjatë rrjedhës së lumit Vardar, me qëllim realizimin e shpejtë të projekteve të leverdishme.

Duke shfrytëzuar trasenë ekzistuese prej 220 kV lidhja Shkup-Kosovë, por edhe njoftimet për ndërtim të kapaciteteve të reja prodhuese në rajonin, Qeveria do të orientohet në ndërtimin më të shpejtë të 400 kV lidhje të re drejt Kosovës. Qeveria do ta përshpejtojë ndërtimin e lidhjes së re prej 400 kV Manastir-Elbasan për të siguruar qasje në rrjetin bartës të Shqipërisë dhe për ta përforcuar rrjetin bartës në rajonin Manastir-Ohër. Qeveria do të sigurojë shfrytëzim të gazit natyror si energjens i lirë dhe ekologjik për secilin në Republikën e Maqedonisë me ndërtim të gazsjellësve magjstralë me teknologji të reja novatore (CNG dhe LND) deri në mjediset urbane dhe rrjetet shpërndarëse.

Qeveria do ta aktivizojë inkuadrimin në TAP (Trans Adriatic Pipeline) për gazifikimin e Maqedonisë jugperëndimore dhe inkuadrimin në sisteme bartëse me Republikën e Bullgarisë dhe Republikën e Greqisë.

Qeveria do t'i thjeshtësojë procedurat për realizimin e projekteve lidhur me burimet energjetike rigjeneruese, do të ngarkojë institucion për instalim të "sistemit njësportel" për marrje të të dhënave, informatave dhe dokumenteve të nevojshme dhe për zbatim të procedurës së plotë deri në realizim. Qeveria do të propozojë edhe ndryshime ligjore për thjeshtësim të procedurës për rregullim të tokës ndërtimore dhe marrje të lejes për ndërtim të kapaciteteve të tilla.

Qeveria do të subvencionojë financiarisht ndërtimin e elektranëve fotovoltaike në ekonomitë familjare dhe do të nxisë zhvillim në ekonominë vendore me hapje të fabrikave për prodhim të paneleve dhe moduleve fotovoltaike. Do të ndërtohet elektranë e re fotovoltaike 10MW me panele të prodhimit të Maqedonisë. Prodhimi i energjisë elektrike deri në fuqinë e instaluar maksimale prej 150 MW me potencialin e erës, do të nxitet përmes një procesi transparent të lejeve dhe vendimeve.

Qeveria do të investojë në pyllëzimin e maleve dhe tokave bujqësore të klasës më të ulët me drunj cilësor energjetik që rriten shpejtë për prodhim të paletave dhe biomasës. Qeveria do të stimulojë investues vendorë dhe/ose të huaj për hapje të fabrikave për prodhim e paletave të drurit dhe ashklave të drurit.

Qeveria do të zbatojë politikë me të cilën çmimi i energjisë termike nga centralet e mëdha kogjeneruese do të shitet me çmim që do të jetë së paku 10% më i ulët se çmimi i stabilimenteve të rregulluara (të kaldajave) gjeneruese.

Me stimuj financiarë, Qeveria do të nxisë përdorim të stabilitimeve kogjeneruese në ekonomitë familjare, por edhe në institucionet shëndetësore publike. Për investim në

instalimet kogjeneruese në bujqësi, Qeveria do të ndajë tokë bujqësore të klasës më të ulët, a.q. zona “energjetike-bujqësore”.

Qeveria do të formojë fond të veçantë për financimin e projekteve efikase energjetike me mjete të siguruara nga kompanitë energjetike dhe fondet dhe grantet nga BE-ja. Do të sigurohet edukim falas i konsumatorëve komercialë dhe industrialë për energji të racionalizuar të konsumatorit.

Për uljen e varfërisë energjetike, Qeveria do të fusë masa prioritare për efikasitet më të madh energjetik, vauçerë energjetikë për qytetarët e përfshirë me Ligjin për varfëri energjetike dhe “rrymë të lirë” gjatë gjithë vikendit dhe 2 orë çdo ditë pune.

Gjatë procesit të krijimit të kushteve për liberalizim të tregjeve energjetike, qeveria do të ketë kujdes në shmangien e goditjeve të mundshme të çmimeve, e veçanërisht në sigurinë në furnizimin me energji.

Me ndryshimet në rregulloren ligjore dhe nënligjore, Qeveria do të mundësojë legalizim të të gjitha objekteve të ndërtuara pa leje të cilat gjenden në ose afër korridorëve të largpërçuesve me tension të lartë.

### **Shoqëria informatike**

Në dhjetë vitet e fundit, zhvillimi i shoqërisë informatike në Republikën e Maqedonisë në raport të vendeve tjera të rajonit, kurse në veçanti në raport të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian, shënon ngecje të konsiderueshme. Ky vlerësim është shënuar në hulumtimin e Kombeve të Bashkuara (“E-Government Survey 2014: E-government for the Future We Want”), publikuar në qershor 2014, në të cilën Maqedonia e zë vendin e fundit në të gjitha segmentet e analizës: indeksi më i vogël i zhvillimit të e-qeverisë nga të gjitha vendet në rajon, Përqindje më e vogël në ofrimin e servisit elektronik drejt qytetarëve, përqindje më e vogël në pjesëmarrje të qytetarëve në sjelljen e vendimeve në pushtetin lokal dhe qendror. Gjithashtu rezultat mund të shihet edhe në hulumtimin e BE, në Organizatën për bashkëpunim ekonomik dhe zhvillim (OECD) dhe të Bankës Botërore.

Qëllimi i Qeverisë do të jetë zhvillimi i IT sektorit (që do të thotë rritjen e eksportit, uljen e papunësisë dhe ndërtimin e brendëve maqedonase) si dhe thjeshtimi dhe shpejtimi i komunikimit mes qytetarëve dhe administratës shtetërore duke shfrytëzuar mu ITK. Për atë qëllim, Qeveria në mënyrë prioritare do të dedikohet në krijimin e regjistrit elektronik si bazë për të gjitha shërbimet qeveritare elektronike të cilat i jepen qytetarëve dhe biznesit.

Për përkrahjen e zhvillimit të këtij sektori, Qeveria do të sigurojë mbrojtje të tërësishme të të drejtat nga intelektualët dhe pronësi industriale nga sfera e teknologjisë informatike dhe do të përpunojë Strategji Nacionale Afatgjate për zhvillim të shoqërisë informatike (në të cilën do të parashihet edhe zhvillim i tregtisë elektronike). Qeveria do të përkrahë formimin e njësisive hulumtuese në sektorin afarist, me qëllim të transferit efikas të teknologjive bashkëkohore.

Qeveria do të udhëheqë politikat në uljen e tatimit të fitimit për informatike dhe teknologji informatike në 5%.

Qeveria financiarisht do ta ndihmojë plasmanin e shërbimeve dhe zgjidhjeve nga ITK kompanitë maqedonase në tregjet botërore, si dhe rikualifikim/kualifikim plotësues të inxhinierëve teknik të arsimit të lartë (teknolog, arkitekt, inxhinier makinerie dhe ndërtimor) në IT-inxhinieri, me qëllim shfrytëzimin e njohurive të tyre informatike dhe uljen e papunësisë të kuadrove teknike.

Qeveria do të sigurojë lehtësime tatimore për IT kompanitë të cilat eksportojnë softuer dhe shërbime. Me atë do të mundësohet rritja e të hyrave devizore, ndërtimin e IT kompanive të reja outsourcing dhe mundësi për punësime të reja.

Në mënyrë plotësuese, Qeveria do t'i ndërmarrë hapat e domosdoshme për hyrje e operatorit të tretë mobil, që t'i ulë çmimet e shërbimeve dhe qytetarëve të kenë shërbime më kualitative.

Qeveria në tërësi do t'i implementojë tre regjistrat themelor elektronik: regjistrin e qytetarëve, regjistrin adresues dhe regjistrin e hapësirave të të dhënave. Këto regjistra u themeluan për të gjitha shërbimet elektronike qeveritare të cilat i jepen qytetarëve dhe bizneset përmes sisteme të cilat shfrytëzohen në administratën shtetërore ( libra amë, lista e vetme zgjedhore dhe tjera), si dhe bazë për të gjitha aktivitetet që duhet të ndërmerren për realizimin e regjistrimit të popullatës në Maqedoni.

Maksimalisht do të zhvillohet e-qeveria dhe servilet qeveritare drejt qytetarëve dhe bizneset për shkak të shpejtimit të procedurave në administratë dhe uljen e shpenzimeve. Me zbatimin e ITK masave më moderne dhe strategji, do të përmirësohet transparenca në punën e institucioneve qeveritare përmes zbatimit të tërësishëm të konceptit të qeverisë së hapur (Open Government). Në këtë mënyrë, do të ulet edhe mundësia për vendime diskrecioni, diskriminim në cilën do bazë dhe do ta forcojë luftën kundër krimit dhe korrupsionit.



## Mjedis jetësor i shëndetshëm

Republika e Maqedonisë, me karakteristikat e resurset e saja natyrore, ofron mundësi për jetë kualitative të qytetarëve. Përmban llojllojshmëri të pasur gjeo-morfologjike dhe biologjike, ujë të mjaftueshëm për pije, liqene të shkëlqyera dhe lyme lumenjsh. Ky është potencial i rëndësishëm për të sotmen dhe gjeneratat e ardhshme.

Po për fat të keq, dëshira për përfitim të shpejtë, Mosrespektim të legjislacionit, mosekzistimit të kapacitetit adekuat institucional dhe kadrovik solli në ndotje enorme të ajrit, tokës dhe ujit dhe prishjen e habitateve natyrore. Dëshpërues është fakti që Republika e Maqedonisë në shekullin XXI probleme të mjedisit jetësor, karakteristike për vendet nga bota e tretë. Qeveria do të sigurojë kualitet më të mirë të medimeve në mjedisin jetësor dhe mbrojtjen e resurseve natyrore përmes institucioneve jo të korrupsionit dhe kapaciteteve institucionale, shërbimeve inspektuese të përforcuara profesionale dhe me pajisje, përkrahje në sektorin privat për arritjen e standardeve të vendosura për mbrojtjen e mjedisit jetësor, lehtësime tatimore gjatë importit të pajisjes së re teknologjike ose instalim të sistemit për pastrim të ujërave të zeza dhe gazrave ndotëse, sigurimin e mjeteve financiare përmes buxhetit, IPA ndihma të BE dhe “masat” kredit e BERZH, BEI dhe Banka Botërore për stimulimin e partneritetit publiko-privat si dhe transparencë e plotë dhe konsultimi gjerë në sferë.

Monitorimi i kualitetit dhe emetimet në ajër, ujë dhe tokë do të jenë të vazhdueshme dhe të arritshme për publikun, shkencën dhe sektorin civil. Do të vendosen indikator ekologjik shëndetësor dedikur për vlerësimin e rrezeve për shëndetin e fëmijëve nga ajri i ndotur.

Qeveria do ta rishikojë vendimin për import të automjeteve të vjetra me qëllim të sigurohet nivel më i ulët i emetimeve në ajër nga komunikacioni. Në komunikacion do të promovojmë përdorimin e derivateve të gazit nga lloji i gazit natyror dhe propan-butan dhe do ta stimulojmë transportin publik dhe të organizuar në mjedise e qyteteve dhe në kompanitë më të mëdha.

Qeveria do të formojë Fond për mjedisin jetësor, si garanci se mjetet e marra nga taksat e mjedisit jetësor, do të dedikohen për projekte për përmirësimin e kualitetit të medimeve në mjedisin jetësor, kurse nuk do të shfrytëzohen për komoditetin e administratës (udhëtime zyrtare, pagimin e telefonit ose pajisjen e kabinetit të ministrave).

Qeveria do të përkrahë ndërtimin e qendrave rajonale për menaxhim me hedhurinat, të cilat në mënyrë adekuate do të ballafaqohen me mbetjet komunale, industriale, mjekësore dhe mbetjet me origjinë shtazore. Që të sigurojmë punë adekuate ekonomike financiare qendrave të qendrave të ardhshme rajonale për menaxhim me hedhurinat, do të bëjmë bazë ligjore për partneritet publik-privat për menaxhim me hedhurinat, shfrytëzimin e fraksioneve të përdorshme dhe përpunimin e prodhimeve sekondare, derivate dhe energji. Kjo nënkupton edhe zgjidhjen e problemit me parregullsitë dhe deponitë e egra, të cilat janë një nga burimet më të mëdha të materieve ndotëse.

Qeveria do të financojë përpunimin e listës prioritare për zgjidhjen e ndotjeve industriale historike dhe revitalizimin e hapësirave degraduese.

Prioritet do të jetë ndërtimi i stacionin për pastrim për trajtim të ujërave të zeza në të gjitha vendbanimet me mbi 10.000 banorë.

Qeveria do ta përkrahë programin për rritjen e hapësirave të gjelbra në qytete, po llojet tona autoktone, të kultivuara në fidanishtet tona- nuk do të importojmë bimë të

ndryshme nga jashtë të cilat janë të shtrenjta dhe nuk mund të aftësohen në kushtet tona klimaterike.

Maqedonia është e pasur me burime të energjisë së regjeneruar, por prapëseprapë i shfrytëzon shumë me kufizim. Për shembull, shfrytëzimi i energjisë diellore në Republikën e Maqedonisë është në nivel më të ulët të mundshëm në krahasim me shtetet evropiane. Do ta lehtësojmë dhe do ta forcojmë subvencionimin e burimeve të rigjeneruara të energjisë ( diell. erë energji gjeotermale dhe biomasa).

Do t'i thjeshtojmë procedurat për projektet energjetike bazuar në energji të rigjeneruar. Përmes programe të dizajnuara speciale, Dedikuar para se gjithash për rajonet rurale, do t'i nxisim qytetarët t'i shfrytëzojnë ato burime rigjeneruese të energjisë që paraqesin mbetje nga procesi prodhues. Potenciali për efikasitet energjetik në Maqedoni është më i madh nga mungesa e përgjithshme e energjisë që mbulohet me import. Ai potencial është më i madh nga kapaciteti i të gjitha hidrocentralet që duhet të ndërtohen dhe të punojnë me tarifa të favorizuara ( fiding). Për shfrytëzimin e atij potenciali do të ndërmerren më shumë masa dhe projekte, të regjistruara në kapitullin **Energjetikë**. Në pajtim me Protokollin nga Kjota, do llogarisim dhe stimulojmë emetimin e ulur të CO dhe nga kursimet e mara në KTe, si karbon kredi do të sigurojmë mjete financiare për efikasitet energjetik. Do të përkrahim krijimin e ESKO kompani si i provuar dhe model i verifikuar për realizimin e projektit për efikasitet energjetik në vendet e Bashkimit Evropian.

Qeveria do të përkushtohet për shoqëri të shëndetshme, humane dhe të drejtë dhe trajtim jo të dhunshëm drejt kafshëve. Duke i ndjekur tendencat evropiane dhe strategjitë qartë të definuar, pranuar nga Këshilli i Evropës dhe Organizata Botërore e Shëndetësisë (ËHO) do të vendosim edhe zbatojmë programe humane për zgjidhjen e problematikës me kafshët, gjatë secilës tërësisht i përfshimë të gjithë shoqatat maqedonase për mbrojtjen e kafshëve duke llogaritur se të njëjtit do të kontribuojnë me njohuritë e tyre, përvoja dhe kapacitetet tjera të cilat vihen në dispozicion.

## Mbrojtja nga katastrofat natyrore

Sipas analizave të Bankës Botërore, Republika e Maqedonisë, çdo ditë e më tepër do të rrezikohet nga fatkeqësitë natyrore, si rezultat i ndryshimeve klimaterike. Nga këto arsye, institucionet tona duhet të jetë të përgatitura që të ballafaqohen me këto sfida dhe ta minimizojnë dëmin për jetën, shëndetin dhe pronën e qytetarëve. Vërshimet në dy vitet e fundit i treguan të gjitha mangësitë sistemore të institucioneve, në veçanti në pjesën e parandalimit dhe sollën deri në viktima të shumta, ndihma e vonuar dhe e pamjaftueshme dhe diskriminim i madh.

Qeveria do ta rishqyrtojë funksionimin e këtyre institucioneve, me saktësi do t'i definojë kompetencat nga secila nga ato dhe do të sigurojë sistem funksional për mbrojtjen e jetës dhe pronës së qytetarëve.. Të gjitha institucionet në sistemin për mbrojtje dhe shpëtim nga katastrofa natyrore do të ekipohen me kuadër profesional adekuat i cili në vazhdimësi do të jetë i trajnuar. Bashkëpunimi i tyre do të ngritet në nivel të konsiderueshëm më të lartë. Do të blihet pajisje bashkëkohore dhe do të ndahet të gjitha institucioneve kompetente, kurse ajo ekzistuese do të mbahet në kondicion të mirë.

Qeveria do vendosë sistem të integruar të menaxhimit me ujërat përmes formimit të Agjencisë së Ujërave. Të gjitha të dhënat për resurset e ujit të mbledhura nga institucionet kompetente do të jenë të integruara në një vend dhe të gjitha aktivitetet do të koordinohen duke shfrytëzuar sistem të vetëm për menaxhim dhe veprim. Duke i shfrytëzuar të gjitha të dhënat e disponueshme nga institucionet, nga komunat, por edhe të gjitha resurset e arritshme të cilat BE i vë në dispozicion, menjëherë do të fillojmë me përgatitjen e planit operativ real për mbrojtje nga vërshimet për rajonet e rrezikuara, kurse do të rishqyrtohen planet për mbrojtje të çdo komune dhe qytetin Shkup. Në vazhdimësi do të zbatohen trajnime dhe informim të popullatës për rreziqet nga vërshimet si dhe të sillen në rast të vërshimit dhe fatkeqësi tjera.

Qeveria do të përpunojë “Kadastër i rajoneve të rrezikuara nga fatkeqësitë natyrore në Maqedoni me shkallën e rrezikut” e cila do të hyjë në të gjitha dokumentet e planit dhe sektorial, që do të definojnë zonat e kuqe ( nuk guxon të ndërtohet), zona të verdha (mund të ndërtohet vetëm me masa mbrojtëse) dhe zona të gjelbra (të lira për ndërtim). Do të forcohet kontrolli i ekspertëve në përgatitjen dhe zbatimin e pjesës së mbrojtjes dhe shpëtim në planet hapësinore dhe urbanistike.

Qeveria do ta përfshijë publikun ekspertësh në krijimin e masave për luftë kundër erozionit dhe rregullimin përroskave, pyllëzim të pyjeve përreth ku me shkatërrimin e pyjeve është kontribuar për erozion të tokës. Do të rishikohet qëndrueshmëria e ndërtimeve të objekteve në rajonet e prekura dhe do të parashihen masa për sanimin dhe mirëmbajtjen e digave. Është evidente që krimi me prerjen e paligjshme të pyjeve do të çrrënjohet me kalimin e sektorit për polici pyjore nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave në kompetencë të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Qeveria do të iniciojë debate rreth ndalesës për ndërtim të objektit në shtratin e lumit dhe do ta sanojmë shtratin e Vardarit qëndrueshmëria e secilës është ulur në mënyrë plotësuere me ndërtimet nga “Shkupi 2014” Gjerësia e rripit të bregut do të definohet në pajtim me standardet evropiane.

Qeveria do të zhvillojë sistem hidrometeorologjik për paralajmërim të hershëm në rast të rrezikut nga moti i keq, që popullata të jetë e informuar në kohë dhe e përgatitur që të ballafaqohet me sfidat. Do të vendoset sistem i vetëm për përgatitjen dhe alarmimit dhe sistemit të vetëm komunikues-informacioni me realizimin e numrit për situata krize -E-112.

Qeveria do t'i shfrytëzojë mundësitë të "Evropa Re" formuar si kompani për ri sigurim përmes partneritetit-publik privat me disa vende në rajon. Në rast të katastrofave natyrore, buxheti i Maqedonisë do të jetë i sigurt, kurse dëmet do të mbuloohen përmes sistemit për ri sigurim. Me shfrytëzimin e teknologjive inovative, sistemi garanton mbulimin e të gjitha dëmeve në pajtim me standardet zvicerane për kualitet, pa subjektivitet, ndikim politik dhe mundësi për korrupsion.

## Kulturë e lirë dhe evropiane

Vlerat kryesore të politikës kulturore të qeverisë janë liria e krijimtarisë, barazia dhe e mira e përgjithshme, ndërkaq parimet më të rëndësishme shtytëse janë qasja, pjesëmarrja dhe kushtet dhe të drejtat e barabarta për të gjithë. Nisemi nga koncepti i demokracisë kulturore, i cili promovon pjesëmarrjen e gjithë qytetarëve në kulturën dhe në krijimin e politikave kulturore. Kultura duhet të ketë funksion progresiv shoqëror: të stimulojë, të polemizojë, të thellojë, të kritikojë, të eksperimentojë, të krijojë vlera të reja. Në tendencat e reja evropiane, kultura nuk njeh kontroll të rreptë nga ana e shtetit. Ajo është e hapur për nga natyra, e hapur ndaj kulturave tjera, e hapur ndaj qytetarëve të saj.

Qeveria nuk do të jetë faktor autoritar i jetës kulturore dhe veprues kryesor në sferën e kulturës, siç ishte deri më tani, por vetëm si rregullator i kornizave të përgjithshme të sistemit kulturor dhe qëllimeve themelore të politikës kulturore. Bartësit kryesor të jetës kulturore do të jenë institucionet dhe organizatat për kulturë, artistët dhe të gjithë njerëzit me vizion kreativ.

Qeveria do të rishqyrtojë modelin aktual të financimit të institucioneve nacionale dhe të projekteve të interesit nacional, do të avancojë ndarjen e vjetruar të veprimtarive dhe sektorëve dhe do të instalojë parimin evropian “arm’s length” në menaxhimin e tyre. Sistemi i ri i financimit do të tejkalojë programin vjetor. Do të krijohen fonde të veçanta për domenet e ndryshme në sferën e kulturës, të cilat do të jenë me autonomi dhe mandat të përkufizuar dhe më afatgjatë dhe do të kenë përgjegjësinë e plotë për selektimin e projekteve. Do të aplikohet modeli i thirrjeve të kombinuara, me data fikse por edhe të ndryshueshme, prej atyre për projekte afatshkurta; deri në projekte më afatgjata, të cilat kanë nevojë për financim dyvjeçar ose më shumë (veçanërisht për t’u dalë në ndihmë projekteve që kanë fituar mbështetje evropiane). Mirëpo, në të njëjtën kohë, do të rishqyrtohet zgjidhja ligjore për financim të Agjencisë për film, të sapofor-muar, me qëllim të përpilohet zgjidhje e drejtë për të gjitha palët e përfshira.

Do të instalohen standarde të reja për punë – transparencë, llogaridhënie, objektivitet dhe efikasitet i të gjithë faktorëve në sistemin kulturor, veçanërisht në institucionet nacionale dhe institucionet tjera publike. Me garantimin e autonomisë në përzgjedhjen e programeve dhe projekteve, do të vendosim praktikë që çdo vendim të ushtrohet sipas kriterëve të qarta dhe të arsyetohet.

Qeveria do të veprojë me ndryshime ligjore dhe thelbësore për kthimin e identitetit dhe vet-respektit të punonjësve dhe veprimtarëve kulturor në institucionet. Fokusi do të jetë mbi autorët dhe verifikimin e duhur të punës së tyre autoriale. Do të fuqizohen transparenca në punën e organizatave kolektive për mbrojtjen e të drejtave autoriale dhe realizimin e tyre, në vazhdimësi do të përforcohet edhe mbrojtja e autorëve veçmas, por edhe e shfrytëzuesve të të drejtave autoriale të cilat janë nën kompetencë të ministrisë.

Qeveria do të stimulojë përpilimin e programeve dhe krijimtarisë me cilësi supreme artistike. Do të insistojmë që të gjitha institucionet dhe organizatat, të cilat kanë përkrahje nga shteti, të hartojnë plane dhe strategji për tërheqjen e publikut dhe për ngritjen e kriterit të publikut për gjykim të cilësive të vërteta të performanseve kulturore.

Qeveria do të rishqyrtojë hollësisht projektin “Shkupi 2014” dhe aspektet politike, juridiko-kushtetuese, ndëretnike, kulturore, arkitektonike, urbano-ndërtimore, financiare dhe estetike në të njëjtin. Për t’u ballafaquar me pasojat e “Shkupi 2014” Qeve-

ria do të thërret të gjitha institucionet kompetente nga sfera e kulturës, shkencës dhe artit. Pasi të përfundojnë të gjitha punët juridiko-kushtetuese, gjyqësoro-penale dhe inspektuese me të cilat do të spastrohen keqpërdorimet dhe krimi i kryer me dhe gjatë këtij ndërtimi gjigant informal, do të iniciojmë masa për revitalizimin e zonës qendrore të qytetit dhe Çarshisë së Vjetër të Shkupit. Në atë mënyrë do të parandalohen zgjidhje të pamatura, të njëanshme dhe me motiv populist.

Qeveria do të përpilojë strategji me masa për sanim të gjendjeve në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore. Do të bëjmë revizion të projekteve të llojit të Kalasë së Shkupit, Pllaoshnik në Ohër, ski-qendra në Galiçicë, plazhi në Llagadin, lagjja e vilave në Fushën e Llazarit (Llazaropole) dhe ngjashëm, që paraqesin kërcënim të drejtpërdrejtë mbi trashëgiminë kulturore dhe natyrore. Në funksion të tejkalimit të vullnetarizmit ekzistues në këtë fushë, sipas shembullit të shteteve të zhvilluara evropiane, do të hartohet Ligj për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, i ri, në të cilin do të përfshihet Listë e monumenteve me domethënie nacionale. Lista do të paraqet dokument me karakter publik, i arritshëm për qytetarët, sipas parimit të kategorisë së vlerës dhe shkallës së cenimit, pa favorizim të llojeve të caktuara të trashëgimisë kulturore. Qeveria do të financojë trajnim të kudarove dhe merit-politikë kadrovike në sferën e konservimit dhe restaurimit.

Do të themelohen mekanizma në kornizë ligjore për valorizim të artit modern dhe arkitekturës si pjesë përbërëse e listës (sipas kriterëve të vlerës, dhe jo kohës së ndërtimit), me çka në të ardhme do të pamundësohet vënia e fasadave në objekte të rëndësishme të llojit të Qeverisë, Qendrës Tregtare të Qytetit në Shkup, ose zonës së vjetër të qytetit në rr. "Makedonija". Njëkohësisht, do të mbrohen Çarshia e Vjetër e Shkupit, lokaliteti Pllaoshnik në Ohër, arkitektura e vjetër e qytetit në Kratovë dhe Shirok Sokak në Manastir dhe Kalaja e Kërçovës.

Qeveria do të formojë trup të pavarur ekspertësh që do të revidojë të gjitha muzetë e reja nga aspekti i vlerës së përmbledhjeve dhe kushteve hapësinore dhe të sigurisë së ekspozimit dhe ruajtjes së tyre, si dhe për zhvillimin e veprimtarisë së muzeve në hap me standardet evropiane dhe botërore. Në atë proces, do të theksohet roli i muzeve në ruajtjen e trashëgimisë kulturore, me fokus në rolin komunikues të muzeve dhe ndërveprimin e tyre me vizitorët.

Qeveria do të bëjë transformim të institucioneve kulturore nacionale në bazë të kriterëve të qarta dhe publike. Institucionet Nacionale, veprimtarinë e tyre programore të parvjetshme do ta caktojnë në negociata të drejtpërdrejta dhe në bashkëpunim me Ministrinë e kulturës, pa pjesëmarrje në konkurse publike, por edhe në mënyrë transparente, me debate publike për propozim programet-vjetore.

Qeveria do t'i stimulojë autoritetet lokale të miratojnë politika lokale kulturore, të instalojnë planifikim strategjik dhe të sigurojnë programe aktive për zhvillim kulturor. Kjo do ta bën sistemin kulturor më efikas dhe më adekuat për nevojat kulturore të qytetarëve. Politika e re kulturore e decentralizimit do të mundojë që në çdo komunë ose bashkësi më e madhe urbane të krijohet së paku një qendër kulturore e komunitetit. Do të krijohen kushte edhe për zhvillim lokal të industrive kreative që do të kontribuojnë për zhvillim ekonomik të komunës në vete.

Politika e re kulturore do të jetë e orientuar kah kultura e gjallë, skena e pavarur kulturore, procesi kulturor dhe praktikat artistike të cilat i ngërthejnë artistët dhe auditorin. Mbështetje do të ketë edhe për nevojat strukturore, për shpenzimet e produksioneve dhe strategjitë për zgjerim dhe zhvillim të cilësisë së projekteve dhe organizatave. Do të përkrahen produksione të reja, praktika eksperimentimi dhe modele të veprimit dhe instalimit të praktikave pozitive të zhvillimit të qëndrueshëm dhe punës. Vëmendje e veçantë do t'u kushtohet të ashtuquajturave



veprimtari kreative dhe industrive kulturore. Do të konsultohen tendencat dhe politikat e shkajshme evropiane, por njëkohësisht aplikimi i tyre do të adaptohet me kontekstin nacional dhe me karakteristikat e tregut dhe publikut në Republikën e Maqedonisë. Vazhdimisht do të rriten mundësitë për krijim të sipërmarrësve kreativ dhe depërtimin e tyre në tregun ndërkombëtar.

Qeveria do të sigurojë fond të veçantë për promovim të artit dhe kulturës sonë jashtë shtetit dhe për bashkëpunim thelbësor rajonal dhe ndërkombëtar. Do të mbështet digjitalizim të plotë të pasurisë sonë artistiko-kulturore (veçanërisht botimet e veprave më të vjetra, punime të rëndësishme dhe periodikë tjetër).

Qeveria do të financojë listë prioritare të kolonive pikturave dhe manifestimeve tjera të cilat më së miri do të plotësojnë interesin publik në artet vizuale, derisa në veprimtarinë teatrale do të caktojë buxhet së paku dyvjeçar për çdo teatër me modele shtesë të financimit (sponzorim, patronazh, donacione afatgjata) dhe mekanizma për pjesëmarrje më të madhe të vetëqeverisjes lokale në financimin e teatrove. Do të kthehet autonomia në vendimmarrje dhe në lidhje me strukturën udhëheqëse dhe në lidhje me programin. Fjalën kryesore do ta kenë trupat përfaqësues të ansamblit, të cilët i marrin vendimet në bazë të kompetencës dhe programit të propozuar. Do të mbështeten vizitat jashtë shtetit dhe angazhimi i regjisorëve me renome ndërkombëtare.

Qeveria do të instaloj transparencë dhe llogaridhënie në miratimin e vendimeve për filmin që meriton të financohet nga ana e shtetit. Do të japim mbështetje për numër më të madh të regjisorëve dhe veprimtarëve tjerë kinematografik të cilët nëpërmjet pjesëmarrjes në më shumë produksione do të përsosin artizanatin e tyre dhe estetikën. Do të insistojmë për produksione me buxhete të pranueshme, me skenarë të mirë dhe ekipe solide të filmit, që do të prodhojnë përmbajtje me vlerë estetike të filmit. Qeveria do të propozojë modele për mbështetje financiare të shfaqjeve kinematografike, me rritjen e kino – rrjetit, por edhe me program më cilësor të filmit. Qeveria do të promovojë sistem të ri për financim të filmave studentor dhe diplomim, në të cilin do të jetë i përfshirë edhe RTM, si përkrahje teknike për filmat studentor dhe me pjesëmarrje të caktuar të fondit, me qëllim ato të fitojnë përvojë dhe renome.

Si mbështetje për të rinjtë dhe angazhim më të madh të tyre kulturor, Qeveria do të financojë teatër rinor, të përbërë nga individ të ri dhe student, që do të mbaj shfaqje nëpër gjithë shtetin. Ky aktivitet do të stimuloj ndërtim ose akomodim në objektet ekzistuese të qendrave rinore, multifunksionale në më shumë komuna dhe qytete ku do të organizohen evenimente publike, shfaqje teatrale dhe kinematografike, mbrëmje oratorike, ekspozita dhe ngjashëm.

## Vetëqeverisje lokale dhe zhvillim i barabartë rajonal

Maqedonia është ende një prej shteteve më të centralizuara në aspektin fiskal në Evropë, ku pjesa dërmuese e komunat nuk kanë mjaftueshëm mjete financiare për realizimin e suksesshëm të kompetencave ligjore dhe të sigurojnë shërbime cilësore për qytetarët. Në mënyrë plotësuese, Republika e Maqedonisë është shtet i zhvilluar në mënyrë jashtëzakonisht të pabarabartë. Dallimet në shkallën e zhvillimit mes komunave urbane dhe atyre rurale janë shumë të mëdha, si dhe mes Qytetit të Shkupit dhe pjesës tjetër të Maqedonisë. Numër i madh i komunave nuk mund t'i mbulojnë as shpenzimet rrjedhëse për shembull, për transport të nxënësve dhe për ngrohje të objekteve shkollore. Jeta në fshatrat dhe komunat më të vogla është shumë e rëndë, për shkak se numër i madh i njerëzve, veçanërisht të rinjtë, shpërngulen në qendrat urbane ose jashtë shtetit.

Qeveria do të bëjë politikë të rritjes së kapaciteteve të komunave por edhe të transparencës dhe llogaridhënies së tyre. Qëllimi është përafrim më i madh i pushtetit me qytetarët, mirëpo edhe përmirësim të shërbimeve dhe cilësi të zmadhuar të jetës në gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë.

Decentralizimi i pushtetit mbetet prioriteti jonë kryesor. Të gjithë qytetarët, pa marrë parasysh nëse jetojnë në qytet ose fshat, kanë të drejtë për arsim cilësor dhe mbrojtje shëndetësore, ujë të pastër, mjedis të shëndoshë jetësor, jetë të sigurt dhe të qetë. Nisemi nga fakti se nuk janë shfrytëzuar kapacitetet e vetëqeverisjes lokale për zhvillimin e shtetit dhe nuk ka demokraci pa vetëqeverisje lokale të zhvilluar. Komunave u transferojmë kompetenca të reja dhe shumë më tepër mjete financiare për zbatimin e suksesshëm të kompetencave të transferuara dhe për sigurimin e shërbimeve më cilësore për qytetarët.

Qeveria financiarisht do të stimulojë hapjen e qendrave për shërbime ku qytetarët do të mund t'i marrin të gjitha shërbimet realizojnë në një vend, shpejtë, me cilësi dhe lirë.

Qeveria do të ushtrojë politikë me të cilën do të eliminohet ndikim subjektiv dhe partiak në bazë të ndarjes së financave publike në vend. Do të sigurojmë mënyrë transparente, të drejtë dhe objektive për ndarjen e bllok-dotacioneve dhe atyre kapitale. Për shkak të gjendjeve katastrofike në këtë sferë, dotacionet kapitale do t'i integrojmë në një sistem, me disa nënsisteme. Do t'i zmadhojmë mjetet dhe do të sigurojmë ndarje transparente dhe të drejtë sipas kriterëve objektive.

Qeveria do t'i instalojë praktikat më pozitive evropiane dhe do t'i zmadhojë mjetet vjetore për zhvillim të barabartë rajonal prej rreth 4 milion në 70 milion euro, me qëllim të stimulohet zhvillimi ekonomik lokal dhe të reduktohen dallimet rajonale. Ministria për vetëqeverisje lokale do të jetë e angazhuar për përcjelljen e vendimeve qeveritare për investime dhe do të jep mendim nga aspekti i zhvillimit të barabartë ekonomik. Njëkohësisht, do të nxitet autonomi më e madhe e Këshillave të rajoneve në vendimmarrje për plane urbanistike, fuqizim të kapaciteteve administrative dhe financiare të Qendrave për zhvillim rajonal (sigurim të statusit të punonjësve shtetëror të punësuar në qendrat dhe mbulim i plotë i shpenzimeve operative nga buxheti qendror).

Për sigurim të shërbimeve cilësore për të gjithë qytetarët, pa marrë parasysh vendbanimin e tyre, do të ndërtojmë sistem objektiv, të drejtë, transparent dhe të qëndrueshëm për barazim të komunave në bashkëpunim të ngushtë me BNJVL. Qëllimi është të sigurohen më tepër mjete financiare për komunat më të vogla dhe të varfra të cilat

vazhdimisht, në bazë të indikatorëve real, kanë kapacitet të ulët tatimor, kurse nevoja të larta financiare.

Qeveria do të formojë Fond për mbështetje të projekteve të komunave, të cilat do të financohen nga IPA dhe programe tjera të BE-së. Fondi do të sigurojë mjete të vazhdueshme dhe të sigurta financiare për projekte kapitale infrastrukturore sikur sisteme të ujësjellësit, ndërtim dhe rikonstruktiv të rrugëve urbane dhe lokale, fabrika rajonale për trajtim të hedhurinave të forta komunale, sisteme kanalizimi dhe kolektorë, pika pastrimi për ujërat e zeza fekale, për gazifikim të komunave, për ndriçim publik, parqe, rregullim të shtretërve lumor etj.

Qeveria do të nis proces me të cilin do të stimulojmë, por edhe do t'i obligojmë komunat të përpunojnë plane urbanistike për të gjitha vendbanimet. Realizimi do të jetë në dy faza, në të parën do të përfshihen vendbanime me mbi 1000 banorë, kurse në tjetrin edhe ato vendbanime janë me më pak se 1000 banorë. Për këto vendbanime do të duhet të përpunohen edhe plane zhvillimore ekonomike, si bazë për zhvillim të qëndrueshëm të komuniteteve. Sipas praktikave pozitive evropiane, planet urbanistike do të kenë afat më të gjatë të validitetit, kurse planet zhvillimore të komunave do të vlejnjë prej 4 deri 6 vite.

Qeveria do të thjeshtësojë dhe ul çmimin e procedurës për marrje të lejes për ndërtim. Në mjediset më të vogla dhe rurale drejtpërdrejtë do të stimulojmë ndërtimin e objekteve për banim dhe ekonomizim. Në këto mjedise konsiderueshëm do të reduktojmë çmimin e tokës ndërtimore dhe tërësisht do të subvencionojmë rregullimin e tokës ndërtimore. Për çiftet e reja martesore dhe ato familje të cilat nuk kanë shtëpinë e tyre do të instalojmë masa për stimulimin e ndërtimit të objekteve për banim. Me këtë do të ndalim shpërnguljen e të rinjve dhe do të krijojmë kushte reale për kthim të jetës në këto mjedise.

Qeveria do të sigurojë përkrahje buxhetore me të cilën deri në fund të periudhës së mandatit do të zëvendësohen të gjitha gypat e ujësjellësve prej azbesti-çimentos dhe të gjitha sipërfaqet e çative të institucioneve publike në kompetencë të vetëqeverisjes lokale. Në të gjitha objektet publike, në kompetencë të vetëqeverisjes lokale do të vendosen fasada për termoizolim, me çka do të kursehen shumë mjete për ngrohje, do të reduktohet prerja e drurëve dhe do të përmirësohen kushtet për qëndrim dhe punë.

Qeveria do të iniciojë reforma në sektorin komunal për t'u përmirësuar cilësia e shërbimeve dhe të rritet produktiviteti. Nëpërmjet transformimeve dhe me forma tjera të organizimit, do të ndërtojmë objekte të reja komunale dhe do t'i rinovojmë ato ekzistuese. Do të vendosim ekuilibër mes biznes-operacioneve profitabile, nga njëra anë dhe në anën tjetër sigurim të shërbimeve të lira, të sigurta, cilësore dhe në dispozicion për qytetarët, nga ana tjetër.

Qeveria do të propozojë instalim të avokatëve të popullit në nivel komunal për mbrojtje më të mirë të të drejtave të qytetarëve, të dëmtuar nga vetëqeverisja lokale.

## **Stimulim për sportin**

Qeveria e Republikës së Maqedonisë do të mbështet politika me të cilat do të zmadhohet numri i qytetarëve, nga të gjitha moshat, grupet sociale dhe mjediset, të cilët çdo ditë bëjnë sport dhe aktivitete rekreativo-sportive. Për atë qëllim, prioritet do t'i japim krijimit të sistemit cilësor të sportit në shkollat dhe universitetet. Përkrahje e veçantë do t'i jepet arritjes së rezultateve të larta sportive në sistemin nacional të ndeshjeve dhe sukses të sportistëve të cilët marrin pjesë në gara ndërkombëtare.

Qeveria do të propozojë Ligj për sport, të ri, me të cilin do të sigurohet status i veprimtarisë së sportit dhe sportistëve në vendin tonë, burime stabile për financim të veprimtarisë së sportit nga buxheti qendror dhe lokal, si dhe mundësi për mbështetje të drejtpërdrejtë të sportit me mjete nga ekonomia.

Qeveria do t'i mbështet federatat nacionale të sportit në krijimin e sistemit nacional bashkëkohor të ndeshjeve dhe tërësisht do të respektojë pavarësinë e federatave nacionale të sportit.

Qëllimi ynë është të zmadhojmë përqindjen e qytetarëve të cilët bëjnë sport prej 2 përqindëshit aktual të popullatës në 20 përqind, të cilët do të jenë të përfshirë në "sporti për të gjithë".

Me vendosjen e modelit të vërtetë të sportit shkollor, do ta zmadhojmë numrin e nxënësve të cilët praktikojnë sport prej 5.000 nxënësve aktualisht në 50.000 në arsimin fillor dhe të mesëm.

Objektet për sport, të cilët prej vitit 2000 janë mjet i manipulimeve dhe eksploitimeve, do t'i kthejmë për nevojat e sportistëve, të rinjve dhe qytetarëve. Ato, aktualisht përdoren për gjithçka tjetër përveç se jo për dedikimin themelor.

Do të sigurojmë kornizë ligjore dhe kushte këto objekte t'i menaxhojnë dhe t'i përdorin njësitë e vetëqeverisjes lokale. Pjesë e tyre do të dedikohen për federatat nacionale të sportit dhe klubet më të mira, kurse ato që janë me cilësi, pajisje, funksionalitet dhe standarde për organizimin e garave të mëdha ndërkombëtare, do të jenë nën kujdes të drejtpërdrejtë të shtetit, në dispozicion të federatave dhe sportistëve.

Qeveria do të iniciojë formimin e fondit financiar për sport në suazat e Agjencisë për të rinj dhe sport ku do të transferohen mjete financiare të dedikuara për zhvillim të sportit. I njëjti do të mbushet nga mjetet për lëshim të licencave për punë të bastoreve sportive, pjesë e secilës pagesë veçmas për tallonave për vënie basti për sport, pjesë e pagesave të lojërave të fatit.

Qeveria do të formojë Këshill Nacional për Sport të përbërë prej pesë federatave më të mira të sportit, të kategorizuara sipas kriterit paraprakisht të caktuar, Kryetari i Komitetit Maqedonas Olimpik dhe drejtori i Agjencisë për të Rinj dhe Sport.

Do të përcaktohen kuota maksimale për fitim të beneficioneve nga shteti, kurse subjektet sportive do të jenë të ndarë në tre kategori varësisht prej shkallës së garës dhe rëndësisë së saj për popullarizimin e sportit dhe promovimin e shtetit. Beneficionet financiare do të merren nëpërmjet ridedikimit të pjesës së tatimit mbi fitim nga ndërmarrjet. Ndërmarrjet do të jenë në gjendje, pjesë të obligimit të tyre për tatim mbi fitim në vend që ta paguajnë për shtetin ta investojnë në klub sportiv ose sportist individual.

